



Njëshmëria e All-lahut

subhanehu ve teala

Salih el Fevzani

Hyrje

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Falënderimi i takon All-llahut, Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë strehim tek All-llahu prej të keqes së vetvetes dhe veprave tona të shëmtuara. Kë e udhëzon All-llahu s'ka kush e lajthit dhe kë e humb Ai, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se përveç All-llahut, një dhe që nuk ka ortak, s'ka hyjni tjetër, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob i Tij dhe i Dërguari i Tij.

“O ju që besuat, kini frikë All-llahun me devotshmëri të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë muslimanë”(3:102).

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe krijo nga ajo të shogen e saj, e prej atyre dyve shtoi shumë burra e gra. Dhe kini frikë All-llahun në të Cilin betoheni, dhe kini kujdes akraballëkun, vërtet All-llahu është mbikëqyrës mbi ju” (4:1)

“O besimtarë, jini të devotshëm ndaj All-llahut dhe thuani fjalë të drejta. Ai do t'ua bën veprat e juaja të mira, do ju shlyej juve mëkatet tuaja, e kush respekton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai ka korrrë një fitore të madhe” (33:70,71)

Kapitulli i Parë

Devijimi në jetën njerëzore

All-llahu, subhanehu ve tealë, i krijoj qeniet me qëllim që ta adhurojnë Atë dhe iu përgatiti atyre nga furnizimet e Tij gjëra që t'u ndihmojnë në jetë. Ai thotë:

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër përveç të më adhurojnë. Unë nuk dua nga ata kurrfarë furnizimi dhe as nuk dëshiroj që ata të më ushqejnë”. (Edh-Dharijat: 56-57).

Nëse shpirti i rikthehet natyrshmërisë së tij, ai do të vërtetojë hyjninë e All-llahut subhanehu ve tealë, do të shpreh dashurin për Të, do ta adhurojë Atë dhe askënd nuk do t'ia bëjë shokë. Shpirtin e shkatërrojnë dhe e shmangin nga kjo natyrshmëri, zbukurimet që i bëjnë atij shejtanët nga njerëzit dhe xhinët duke i shpallur njëri-tjetrit fjalë zbukuruese e mashtruese. Tevhidi (monoteizmi) është i mbjellur (i lindur) në zemrën e njeriut. Shirku (politeizmi) është rastësor dhe i huaj në të. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“Përqendro vetveten tënde singërisht në fenë, i larguar prej çdo gjëje te kotë, (e ajo fe), feja e All-llahut në të cilën i krijoj njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) prej asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu; ajo është feja e drejt por shumica e njerëzve nuk e dinë” (Err-rrum: 30).

Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: “çdo fëmijë lindë në natyrshmëri (në besim të vërtetë) kurse prindërit e bëjnë atë çifutë, të krishterë apo mexhusi (zjarr putist)”. ***Pra bazë tek njeriu është Tevhidi.***

Feja islame fillon qysh nga Ademi, alejhis-selam, dhe mbijetoi në dhurrijetin (pasardhësit) e tij disa shekuj. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“Njerëzit ishin një ummet (një fe), (e pastaj pasi u përçanë) All-llahu dërgoj profetët përgëzues e qortues” (El-Bekare:213).

Shirku dhe devijimi i parë nga besimi i drejtë ndodhi në popullin e Nuhit, alejhis-selam, ai ishte i Dërguari (resuli) i parë.

“Ne të shpallëm ty ashtu sikurse i shpallëm edhe Nuhit dhe profetëve pas tij ...” (En-Nisa:163).

Ka thënë Ibnu Abbasi : *“Mes Ademit edhe Nuhit, alejhis-selam kaluan dhjetë shekuj, i gjithë njerëzimi jetonte në islam. Thotë ibnul-Kajjimi: “kjo thënie është e saktë në mënyrë të prerë. Këtë e dëshmon fjala e All-llahut, subhanehu ve tealë :*

“Njerëzit ishin një ummet (një), pastaj u përçanë ...” (Junus:19).

Ky dijetarë (All-llahu, subhanehu ve tealë, e mëshiroftë) dëshiron të thotë se dërgimi i pejgamberëve u bë për shkak të përçarjes në fenë e vërtet, sikurse ishte rasti me arabët të cilët pasonin fenë e Ibrahimit, alejhis-selam, derisa nuk e ndryshoi atë Amr ibn Luhaj El-Huzaiji, i cili e ndërrojë Fenë e Ibrahimit, alejhis-selam, dhe i barti idhujt në tokën arabëve dhe në tokën e hixhazit (Meivës) në veçanti, të cilët idhujt pastaj adhuroheshin përveç All-llahut, subhanehu ve tealë.

Në këtë mënyrë u përhap shirku në këto vende të shenjta dhe rreth tyre, derisa dërgoi All-llahu subhanehu ve tealë, të zgjedhurin e Tij, Muhammedin, s.a.v.s. vulën e profetëve, i cili i ftoi njerëzit në monoteizëm, në vijimin e fesë së Ibrahimit dhe luftoi për All-llahun, subhanehu ve tealë, me luftë të vërtetë derisa u kthye besimi monoteist dhe feja e Ibrahimit. Ai plotësojë fenë, plotësojë begatinë e Tij ndaj botëve dhe kështu sipas rrugës së Tij (Islamit) vazhduan tre shekujt e lavdëruar në fillim të këtij ummeti, derisa u përhap përsëri injoranca në shekujt e mëvonshëm dhe u përzien në të elemente nga fetë tjera, kështu që u rikthye shirku tek shumica e këtij ummeti me ndikimin e thirrësve të devijimit për shkak të ndërtimit mbi varreza, duke kërkuar kështu respekt ndaj evliave (besimtarëve të devotshëm) e bamirësve dhe duke shfaqur adhurim për ta; - duke ndërtuar tyrbet mbi varrezat e tyre. Ata, pastaj u bënë idhujt që adhurohen përveç Zotit më lloj-lloj formash sikurse janë : Lutja e tyre, kërkimi i ndihmës nga ata, prerja e kurbanit, betimet për ta. Këtë shirk ata e quajtën ndërmjetësim tek bamirësit dhe shprehje e dashurisë ndaj tyre. Ata harruan se kjo ishte fjala e politeistëve të parë, të cilët thanë:

“Në ata (idhujt) nuk i adhurojnë për tjetër, veç se të na ofrojnë tek All-llahu sa më afër...” (Ez-Zumer:3). Më gjithë paraqitjen e këtij shirku në të kaluarën dhe sot, prapë se prapë, shumica e tyre besojnë në Tevhidurr-Rrububie (se All-llahu është Krijuesi e Furnizuesi i çdo gjëje), por ata bëjnë shirk në Tevhidul-Uluhie (Në atë se vetëm All-llahu meriton adhurimin), sikur se thotë All-llahu subhanehu ve tealë: “...shumica e tyre nuk e beson ndryshe All-llahun, përveç se duke i bërë shirk Atij ...” (Jusuf:106). Ekzistimin e All-llahut, subhanehu ve tealë, nuk e mohoj askush, përveç një numri të vogël nga njerëzit, si Faraoni dhe sikurse janë ateistët komunistë në këtë kohë. Ky injorim i tyre bëhet nga mendjemadhësia për ndryshe, ata janë të detyruar të vërtetojnë ekzistimin e Tij në brendësinë (zemrat) e tyre,

sikurse thotë All-llahu, subhanehu ve tealë: “...ata i refuzuan ato (ajetet e All-llahut) si shkak i mizorisë së tyre dhe nga mendjemadhësia, edhe pse zemrat e tyre ishin të bindura në to .” (En-neml:14).

Mendimet e tyre se çdo krijesë nënkupton krijuesin, çdo e formuar ka formuesin dhe sistemi i përpiktë i kësaj Gjithësie, pa tjetër duhet të ketë një themelues të Urtë, të Fuqishëm, dhe të Gjithëdijshëm. Ai që refuzon Atë, është i çmendur ose është mendjemadh, që nuk përdorë logjikën, e i cili nuk merret parasysh.

Esh-shirk - Politeizmi

a) Përcaktimi i tij

Shirk është t’i bësh All-llahut, subhanehu ve tealë, shok në rububijetin (se All-llahu është Krijues dhe furnizues i vetëm) dhe në uluhijetin e Tij (se vetëm Ai meriton dhe duhet të adhurohet). Shirku në uluhijetin e All-llahut, në të shumtën e rasteve, është t’i lutesh dikujt tjetër bashkë me All-llahun, subhanehu ve tealë, apo kryerja në emër të tij e disa llojeve të ibadeteve, sikurse janë: therja, betimet, frika, shpresa dhe dashuria për të.

Shirku është mëkati më i madh për disa arsye:

1) Sepse ai e bën një të (ngjashëm), krijesën me Krijuesin në veçoritë e uluhijetit (të cilat veçori janë vetëm për All-llahun). Ai që shoqëron dikë me Zotin, e ka personifikuar atë me Te. Kjo është mizoria më e madhe. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë :

“Vërtetë, shirku është një mizori e madhe “ (Lukman:13).

Mizori është të vësh një gjë në një vend që nuk e meriton. Ai që adhuron dikë përveç All-llahut subhanehu ve tealë, ka vënë adhurimin në vend që nuk i takon dhe i është drejtuar atij që nuk e meriton, e kjo është mizoria më e madhe.

2) All-llahu, subhanehu ve tealë na lajmëroj se nuk ja fal këtë mëkat atij që nuk pendohet. Ai thotë:

“Vërtetë, All-llahu nuk falë t’i bëhet shirk Atij, kurse përveç këtij mëkati i fal kujt dëshiron Ai...” (En-Nisa:48).

3) All-llahu, subhanehu ve tealë, na lajmëroj se mushrikut (politeistit) ia ka ndaluar Xhennnetin dhe ai do të hyjë në Xhehnnem përgjithmonë:

“Vërtetë All-llahu, atij që i bën shirk, ia ka ndaluar xhennnetin, vendi i tij është zjarri dhe për mizorët nuk ka ndihmëtarë”(El-Maide:72).

4) Shirku rrënon të gjitha veprat. All-llahu subhanehu ve tealë thotë:

“Sikur ata (besimtarët) të bënin shirk do t’ju shkatërrohej çdo gjë që punonin (nga veprat e mira)” (El- En’am : 88), dhe thotë :

“Ty veç të është shpallur, po edhe atyre që ishin para teje (profetëve) ; “Po që se i bën shirk (Allahut), do të shkatërrohet puna jote dhe do të jesh nga të shkatërruarit” (Ez-Zummer:65).

5) Gjaku dhe pasuria e mushrikut (politeistit) janë të lejuara. All-llahu subhanehu ue teuala thotë:

“...luftoni idhujtarët ku do që t’i gjeni, robëroni dhe ngujoni ata dhe vëruni pritë në çdo shteg...” (Et-Tevbe:5). Kurse Muhammedi s.a.v.s, tha: ***“Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit deri të thonë La ilahe il-lall-llah e kur të thonë këtë, i kanë të mbrojtura nga unë gjakun dhe pasurinë e tyre, përveç me hakun e tyre (nëse meritojnë një gjë të tillë)”***.

6) Shirku është mëkati më i madh. Muhammedi s.a.v.s, tha: ***“A t’iu lajmëroj për mëkatet më të mëdha”***. Thanë (sahabët): - *po si jo, o i dërguari i Allahut*. Tha: ***“Shirku ndaj Allahut dhe mos respekti ndaj prindërve”***. Tha dijetari i madh Ibnul Kajimi: *“All-llahu subhanehu ve teal, lajmëroj se qëllimi i krijimit dhe i urdhërimit është të njihet Allahu përmes emrave dhe cilësive të Tij dhe vetëm Ai të adhurohet dhe asgjë të mos i shoqërohet. Kurse njerëzit ta ruajnë drejtësinë me të cilën qëndrojnë qiejt dhe toka, sikurse thotë All-llahu, subhanehu ve teal:*

“Ne i dërguam të Dërguarit Tanë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës...”(EL-Hadid:25)

Pra ,All-llahu, subhanehu ve teal, na lajmëroi se i dërgoi profetët dhe i zbriti librat e Tij, që njerëzit të mbajnë drejtësi, e drejtësia më e madhe është tevhidi (pranimi i njësisë së All-llahut). Ai është koka dhe trupi i drejtësisë. Kurse shirku është mizori , sikurse thotë All-llahu , subhanehu ve teal:

“Vërtetë, shirku është një mizori e madhe (ndaj All-llahut)“ (Llukman :13).

Pra, shirku është nëna e mizorisë, kurse tevhidi është nëna e drejtësisë. Ajo që më së shumti mohon këtë qëllim (tevhidin) është mëkati më i madh në përgjithësi. All-llahu subhanehu ve teal, ia bëri haram (të ndaluar) Xhenetin mushrikut (politeistit) dhe lejoi gjakun, pasurinë, dhe familjen e tij për Ehlut–tevhidin (monoteistët), sikurse u lejoi t’i robërojnë ata për shkak të lënies së adhurimit të Tij. All-llahu, subhanehu ve teal, refuzoi të pranojë çfarëdo veprë nga mushriku, të pranojë ndërmjetësimin për të, t’i përgjigjet lutjes së tij Ditën e Kiametit ose të pranojë ndonjë shpresë të tij.

Mushriku është injoranti më i madh në Zotin, sepse i bëri Atij shok nga mesi i krijesave të Tij. Ky është kulmi i injorancës ndaj Zotit, sikurse është edhe kulmi i mizorisë ndaj Tij edhe pse mushriku, në realitet nuk e ka mizoruar Zotin e tij por e ka mizoruar veten.

7) Shirku është mangësi dhe shëmtim nga të cilat Zoti spastroi Vetën.

Ai që i bën shok Zotit, i ka shpifur Atij atë që Ai Vetë e ka spastruar Vetën nga ajo. Ky është kulmi i ballafaqimit dhe i konfrontimit me All-llahun, subhanehu ve teal.

b) Llojet e tij

Shirku ndahet ne dy lloje :

Lloji i parë: Shirku i madh i cili largon nga mileti islam (nga feja Islame) dhe vepruesi i tij hyn në zjarr përgjithmonë, nëse nuk pendohet nga ai.

Shirku i madh është t’i kushtosh ndonjë lloj ibadeti (adhurimi) diku tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve teal, sikurse janë p.sh. lutja, afrimi me therje dhe zotime tek

varrezat, xhinët dhe shejtanët. Frika se të vdekurit, xhinët apo shejtanët mund të bëjnë dëm apo ta sëmurin dikë

Shpresa ndaj ndonjë gjëje që nuk ka mundësi atë askush tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve tealë, sikurse janë: arritja e qëllimeve dhe largimi i vështirësive, të cilat sot praktikohen tek tyrbet e ndërtuara mbi varrezat e evliave dhe njerëzve të mirë. All-llahu, subhanehu ve tealë , thotë :

“... ata adhurojnë përveç All-llahut çka nuk u bën dëm e as dobi dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek All-llahu ...”(Junus:18).

Lloji i dytë: Shirku i vogël: i cili nuk largon nga mileti islam (feja Islame), por ai pakëson tevhidin dhe është rrugë deri te shirku i madh. Ky ndahet në dy lloje:

1) Shirku i qartë (i hapët): Ato mund të jenë fjalë ose vepra. Prej fjalëve është p.sh. betimi në dikë tjetër e jo në All-llahun, subhanehu ve tealë. Muhammedi ,s.a.v.s, thotë: “Ai që betohet në diçka tjetër, përveç All-llahut, subhanehu ve tealë, ai veç ka mohuar dhe ka bërë shirk”, si dhe fjalët “Çka All-llahu, subhanehu ve tealë dëshiroi dhe çka dëshirove ti”. Tha Muhammedi s.a.v.s, kur një njeri i tha: “çka dëshiroj All-llahu dhe dëshirove ti?”, - “A më bërë shok me All-llahun? Thuaj: çka vetëm All-llahu dëshiroi”. Dhe fjala: “Sikur mos të ishte All-llahu subhanehu ve tealë, dhe filani”. E drejt është të thuhet: çka dëshiron All-llahu, subhanehu ve tealë, pastaj çka dëshiron filani edhe sikur mos të ishte All-llahu, subhanehu ve tealë, pastaj sikur mos të ishte filani, sepse fjala “pastaj” e bën dëshirën e njeriut të varur nga dëshira e All-llahut, subhanehu ve tealë, sikur thotë All-llahu, subhanehu ve tealë :

“Ju nuk keni për të dëshiruar përveç se çka dëshiron All-llahu, Zoti i botëve”(Et-Tekvir: 29). Të ngjashme me këto janë edhe fjalët: “Unë nuk kam tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve tealë, dhe ty”, dhe fjalët: “Këto janë nga begatitë e All-llahut, subhanehu ve tealë , dhe begatitë e tua”. Kurse veprat: sikur janë p.sh. ngjitja e hajmalive, penjve të ndryshëm, duke u ruajtur nga syri i keq, me bindje se këto janë shkaqe për largimin e belasë, janë shirk i vogël, sepse All-llahu, subhanehu ve tealë, nuk i bëri këto gjëra shkaqe. Nëse besohet se këto gjëra vetvetiu largojnë belanë është shirk i madh, sepse një gjë e tillë është mosmbështetje në All-llahun, subhanehu ve tealë.

2) Shirku i fshehur: Ky është shirku në dëshira dhe qëllime, sikurse janë: Syfaqësia (të shtirurit) dhe autoriteti, si p.sh. të punosh një vepër që të afron tek All-llahu, subhanehu ve tealë , me qëllim që të të lavdërojnë njerëzit ose e zbukuron namazin e tij, ose jep sadak me qëllim që të lavdërohet ose e zbukuron zërin e tij gjatë leximit të Kur’anit që njerëzit ta dëgjojnë dhe ta lavdërojnë. Nëse syfaqësia e shoqëron një vepër, ajo e prish atë, sepse All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“Ai që shpreson takimin me Zotin e tij, le të punoj vepra të mira dhe në adhurimin e tij mos t’i bëj Atij shirk askë” (Ek-Kehf: 110).

Muhammedi ,s.a.v.s, tha: “Më së shumti ua kam friken nga shirku i vogël: Thanë (shokët e tij); O i dërguar i All-llahut! Ç’është shirku i vogël ? Tha: “Syfaqësia (veprimet sa për sy e faqe).” Këtu hyn edhe veprat (ibadetet e veprat e mira) që bëhen për ndonjë pasuri të kësaj bote, p.sh. si ai që kryen haxhin për t’i thënë njerëzit haxhi, ose kryen namazin si imam vetëm për pasuri ose mëson diturit fetare dhe lufton në rrugën e Zotit vetëm për pasuri.

Muhammedi s.a.v.s, tha: “U shkatërrua robi i dinarit, u shkatërrua robi i dirhemit, u shkatërrua robi i gunës, u shkatërrua robi i kadifes, nëse i jepet gëzohet e nëse nuk i jepet hidhërohet”.

Ibnul-Kajjimi (rahiemullah) ka thënë: “Shirku në dëshira dhe qëllime është deti pa breg, pak kush shpëton nga ai. Ai që më punën e tij nuk dëshiron fytyrën (kënaqësinë) e All-llahut, subhanehu ve tealë, dhe bëri njet diçka tjetër, përveç afrimit tek Ai dhe kërkimit të shpërblimit nga Ai, ka bërë shirk me qëllimin dhe dëshirën e tij. Kurse **ihlasi** (sinqeriteti) është të jesh i sinqertë ndaj All-llahut subhanehu ve tealë, në veprat, fjalët, dëshirat dhe qëllimet e tua. Kjo është feja e pastër e Ibrahimit me të cilën All-llahu, subhanehu ve tealë, i urdhëroi të gjithë robërit e Tij. Ai nuk pranon diçka tjetër përveç kësaj dhe ky është realiteti i Islamit, sikurse tha All-llahu, subhanehu ve tealë:

“Ai që dëshiron fe tjetër përveç Islamit, ajo nuk do t’i pranohet atij dhe ai në botën tjetër do të jetë nga të shkatërruarit”. (Ali-Imran:85).

Nga e gjithë kjo mund të përfundojmë se në mes shirkut të madh e të vogël ka disa dallime:

- 1) Shirku i madh të largon nga mileti Islam, kurse i vogli nuk të largon
- 2) Shirku i madh të shpie në zjarr përgjithmonë kurse i vogli jo.
- 3) Shirku i madh shkatërron të gjitha veprat, kurse i vogli nuk i shkatërron të gjitha veprat, por i shkatërron vetëm ato për syfaqësi, vepra që bëhen për interesa të kësaj bote dhe vepra që u bashkëngjiten këtyre.
- 4) Shirku i madh lejon gjakun dhe pasurin, kurse shirku i vogël nuk i lejon ato.

Kufri-Mosbesimi

a) Përkufizimi i tij

Fjala El-Kufr në gjuhën arabe ka kuptimin e mbylljes dhe mbulimit, kurse në terminologjinë islame, kufri është e kundërta e imanit. Kufri është mosbesimi në All-llahun, subhanehu ve tealë, dhe në profetët e Tij, pa marrë parasysh përgënjeshttrimin apo mos përgënjeshttrimin e tyre, por mjafton vetëm ekzistimi i dyshimit, kundërshtimit, zilisë, mendjemadhësisë ose pasimi i dëshirave të cilat pengojnë nga pasimi i shpalljes, edhe pse përgënjeshtrimi është kufri më i madh. I ngjashëm është edhe ai që përgënjeshton ata nga zilia duke qenë i bindur se ata janë të vërtetë.

b) Llojet e tij

Kufri ndahet në dy lloje :

Lloji i parë: Kufri i madh: i cili largon nga mileti islam. Ai ndahet në pesë lloje:

1) Kufri i përgënjeshtimit: Argument për këtë është fjala e All-llahut, subhanehu ve tealë: *“Kush është më mizorë se ai që shpif gënjeshtër ndaj All-llahut ose përgënjeshtroj hakkun (të vërtetën) kur ai erdhi? A nuk mjafton xhehnnemi vendqëndrim për pabesimtarët?”* (El-Ankebut: 68).

2) Kufri i refuzimit dhe mendjemadhësisë me vërtetim: argument për këtë është fjala e All-llahut, subhanehu ve tealë:

“Përkujto (Muhammed) kur Ne u thamë melaqeve: Bëni sexhde Ademit. Të gjithë i bënë sexhde përveç Iblisit (shejtanit), ai refuzoi, bëri mendjemadhësi dhe u bë nga pabesimtarët” (El-Bekare: 34).

3) Kufri i dyshimit (kufri i supozimit): Argument për këtë është fjala e All-llahut, subhanehu ve tealà:

“Dhe ai hyri në kopshtin e vet (me besimtarin për dore), por duke qenë dëmtues i vetes (duke mos besuar dhe duke u krenuar) tha: “Unë nuk mendoj se do të zhduket ky (kopshti im) ndonjëherë”. Dhe nuk besoj se do të ndodhë Kiameti, por nëse bëhet që të kthehem te Zoti im, pa dyshim do të gjej ardhmëri edhe më të mirë se kjo. Shoku i vet (besimtari) i tha atij duke e polemizuar. “A e mohove Atë që të krijoj ty nga dheu, pastaj nga një pikë uji, pastaj të bëri njeri të plotë” (El-Kehf: 35-37).

4) Kufri i refuzimit: Argument për këtë është fjala e All-llahut, subhanehu ve tealà :
“Ata të cilët mohuan, refuzojnë qortimet tona”. (El-Ahkaf: 3).

5) Kufri i nifakut (dyfytërsisë): Argument për këtë është fjala e All-llahut, subhanehu ve tealà:

“Kjo për arsye se ata besuan e pastaj mohuan, kështu që ne u vulosëm zemrat e tyre dhe ata nuk kuptojnë” (El-Munafikun: 3).

Lloji i dytë: Është kufri i vogël që nuk të largon nga mileti Islam. Ai është kufri veprues (praktik), e që janë Gjynahet që në Kur’an dhe Sunnet janë quajtur kufr, por që nuk kanë arritur shkallën e kufrit të madh, sikurse është p.sh. kufri i ni’meteve (mohimi i begative të All-llahut, subhanehu ve tealà) i përmendur në fjalën e All-llahut, subhanehu ve tealà .

“All-llahu sjellë si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banoret) i përbuzen te mirat e All-llahut...” (En-Nahl: 112).

Në të njëjtën shkallë është edhe lufta kundër muslimanit e përmendur në fjalën e Muhammedit, s.a.v.s : “Sharja e muslimanit është fusuk (mos respekt ndaj Zotit, kurse të luftosh kundër tij është kufr”, dhe fjala e tij: “ Mos u ktheni pas meje (pas vdekjes sime) në pabesimtarë, e t’i mëshoni njëri tjetrit (me shpata)”. Gjithashtu, **betimi** në dikë përveç All-llahut, subhanehu ve tealà, është në të njëjtën shkallë, sepse Muhmmedi, s.a.v.s tha: “ Ai që betohet në diç tjetër përveç All-llahut subhanehu ve tealà, ka bërë kufër ose shirk”. All-llahu subhanehu ve tealà e quajti vepruesin e gjynahit të madh besimtarë. Ai tha:

“O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje...” (El-Bekare: 178).

Vrasësin All-llahu, subhanehu ve tealà, nuk e nxorri nga ata që besuan dhe e bëri vëlla të përgjegjës për hakmarrje në vrasje, e tha: *“Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet atëherë ajo le të përcillet kuptueshëm...” (El-Bekare: 178)*

Këtu, padyshim, është për qëllim vëllazëria e fesë. All-llahu subhanehu ve tealà, thotë:

“Nëse dy grupe në mesin e besimtarëve luftojnë ndërmjet vete, pajtoni ju ato...” deri tek fjala e Tij: “Vërtet besimtarët janë vëllezër, andaj pajtoni vëllezërit mes veti ...” (El-Huxhurat: 9-10).

Paraqitje e përmbledhur e dallimeve, mes kufrit të madh dhe të vogël:

1) Kufri i madh largon nga mileti islam dhe i shkatërron veprat e mira, kurse kufri i vogël nuk largon nga mileti Islam dhe nuk i shkatërron veprat e mira, por i pakëson ato dhe atë sipas madhësisë së tij edhe vepruesi i tij i nënshtrohet qortimit.

2) Kufri i madh e shpije njeriun në zjarr përgjithmonë, kurse vepruesi i kufrit të vogël nëse hyn në Xhennem, nuk qëndron aty përgjithmonë. Gjithashtu, All-llahu, subhanehu ve teala, mund t'ia falë atij, kështu që nuk hyn fare në zjarr .

3) Kufri i madh lejon gjakun dhe pasurinë, kurse kufri i vogël nuk i lejon ato.

4) Kufri i madh detyron armiqësinë e singertë mes vepruesit të tij dhe besimtarëve. Nuk i lejohej besimtarëve ta duan dhe shoqërojnë atë edhe nëse është njeriu më i afërt i tij. Kurse kufri i vogël nuk e pengon dashurinë, por vepruesin e tij duhet dashur dhe shoqëruar sipas masës së imanit të tij dhe urrehet e armiqësohet sipas masës së mos respektit të tij (ndaj All-llahut, subhanehu ve teala).

Nifaku-Dyftytyrësia

a) Përkufizimi i tij

Fjala nifak në gjuhën Arabe rrjedh nga fjala “en-nefek” që është vendi apo shpella ku fshihet njeriu. Kurse nifaku në terminologjinë Islame ka kuptimin e shprehjes së islamit dhe fshehjes së kufrit e sherrit. Është quajtur kështu sepse nga një anë hynë në Sheriatin Islam, ndërsa nga një anë tjetër del nga ai. Këtë na përkujton All-llahu, subhanehu ve teala, kur thotë: *“Vërtet munafikët janë ata të prishurit-fasiket”* (Et-Tevbe: 68), d.m.th. të dalurit nga sheriat (ligji Islam)

All-llahu, subhanehu ve teala, i bëri munafikët me të këqij se sa kafirat :

“Vërtetë munafikët janë në shkallën me të ulët të xhehnnemit” (En-Nisa: 145), dhe tha: *“Vërtetë, munafikët (dyftytyrshat) përpiqen ta mashtrojnë All-llahun, por Ai i mashtron ata...”* (En-Nisa: 142) dhe

“Ata mendojnë se mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan por në realitet ata nuk mashtrojnë askënd përveç vetes, por këtë gjë ata nuk e hetojnë. Në zemrat e tyre kanë sëmundje e All-llahu ua shton sëmundjen dhe ata kanë dënim të dhimbshëm për atë që përgënjeshtrojnë” (El-Bekare: 9-10).

b) Llojet e tij

Nifaku ndahet në dy lloje :

Lloji i parë: Nifaku në besim: Ky është nifaku më i madh, me ç'rast njeriu shpreh islamit dhe e fsheh kufrin, ky lloj nxjerr njeriun nga feja në përgjithësi dhe e hedh atë në vendin me të ulët të zjarrit. All-llahu, subhanehu ve teala, i përshkroi munafikët (dyftytyrshat) me të gjitha tiparet e sherrit: me kufr, mosbesim, përqeshje me fe e me fetaret dhe me anim ka armiqësi të islamit në përgjithësi për shkak të bashkimit të tyre në armiqësi kundër islamit. Ata janë të pranishëm në çdo kohë posaçërisht, kur Islami është i fortë dhe ata nuk kanë

mundësi të ballafaqohen me të haptas. Me këtë rast ata shprehin hyrjen në të me qëllim që t'i bëjnë kurthe atij dhe pjestarëve të tij dhe me qëllim që të jetojnë me muslimanët e të jenë të sigurt në gjakun dhe pasurit e tyre. Munafiku shpreh besimin në All-llahun, subhanehu ve teala, në melaqet e Tij, në librat e Tij, në të Dërguarit e tij dhe në Ditën e Gjykimit, kurse në brendësinë e tij është i zhveshur nga këto dhe është përgënjeshtues i tyre. Ai nuk beson në Allahun, subhanehu ve teala, nuk beson se All-llahu subhanehu ve teala, u foli (me shpalljen e tij) disa njerëzve të cilët i bëri të dërguar te njerëzit, përmes të cilëve, Ai i udhëzon ata dhe i qorton nga dënimi i Tij. All-llahu, subhanehu ve teala, në Kur'an ngriti mbulesën nga këta munafik dhe zbuloi fshehtësinë e tyre dhe ia bëri të qarta robërve të tij çështjet e tyre që t'i ruan nga ta. Në fillim të sures El-Bekare ai përmendi tri llojet njerëzore: besimtarët, pabesimtarët dhe munafikët. Për besimtarët aty shpalli katër ajete, për pabesimtarët dy ajete, kurse për munafikët trembëdhjetë ajete si shkak i shumicës së tyre, belasë së përgjithshme të tyre dhe për shkak të sprovimeve të shumta të Islamit e të pjesëtarëve të tij nga ata. Sprovimi i Islamit nga ata është shumë i madh, sepse ata i përkasin atij, kinse e ndihmojnë dhe e duan atë, kurse në realitet janë armiq të tij

Ky nifak ndahet në gjashtë lloje:

- 1) Përgënjeshtrimi i Muhammedit s.a.v.s .
- 2) Përgënjeshtrimi i një pjese nga ajo (nga Kur'ani) që ju shpall Muhammedit a.s.
- 3) Urrejtja ndaj Muhammedit s.a.v.s.
- 4) Urrejtja ndaj një pjese nga ajo që ju shpall s.a.v.s.
- 5) Gëzimi kur feja e Muhammedit s.a.v.s, Islami bie poshtë
- 6) Urrejtja kur feja e Muhammedit, s.a.v.s. Islami triumfon.

Lloji i dytë: Nifaku veprues (praktik): Është veprim i ndonjërit nga veprat e munafikëve me mbetjen e imanit në zemër. Ky nifak nuk të largon nga mileti islam, por, është rrugë deri të një gjë e tillë. Vepruesi i këtij nifaku zotëron në të njëjtën kohë edhe imanin edhe nifakun, nëse nifaku i shumohet, për shkak të tij bëhet munafik i pastër. Kurse tek ai që gjendet një cilësi nga nifaku ai posedon një cilësi të tij deri sa ta lë atë, e ato janë: *"...kur t'i besohet-tradhton, kur flet-gënjen, kur premtan-mashtron dhe kur bije në armiqësi-i tejkalon kufijtë,* tek ai që bashkohen këto katër cilësi tek ai është bashkuar shërrin në përgjithësi dhe janë shoshitur veçorit e munafikëve tek ai. Kurse ai që zotëron një cilësi nga ato shfaqë një cilësi të nifakut, sepse tek njeriu mund të bashkohen cilësitë e hajrit dhe të shërrit dhe cilësitë e imanit dhe cilësitë e kufrit e të nifakut. Ai njeri meriton dënim e shpërblim sipas sasive të veprave të tij. Prej veçorive të munafikëve është edhe përtacia për faljen e namazit me xhemat në xhami. Pra nifaku është shërr dhe është shumë i rrezikshëm. Sahabet (shokët) e Muhammedit, s.a.v.s, kishin shumë frik nga rënia në të. Ibni Ebi Melike tha: " Takova tridhjetë vetë nga sahabet e Muhammedit, s.a.v.s, të gjithë ja kishin frikën vetës nga nifaku".

Dallimi në mes te nifakut të madh dhe nifakut të vogël

- 1)** Nifaku i madh të largon nga mileti Islam, kurse i vogli jo.
- 2)** Në nifakun e madh dallohet bindja e brendshme me pamjen apo formën e jashtme tek njeriu në besim, kurse te nifaku i vogël dallimi i bindjes së brendshme me atë te jashtme bëhet në vepra e jo në besim .
- 3)** Nifaku i madh nuk mund të ndodhë tek besimtari kurse i vogli mund te ndodh tek ai .
- 4)** Në të shumtën e rasteve, vepruesi i nifakut të madh nuk pendohet, edhe nëse pendohet dijetaret ranë në dilemë a pranohet pendimi i tij apo jo, derisa vepruesi i nifakut të vogël mund të pendohet tek All-llahu, subhanehu ve teal, dhe Ai t'ia fal.

Dijetari i famshëm ibnu Tejmije tha: “Shumë herë mund t’i paraqitet besimtarit ndonjë kategori nga kategoritë e nifakut, por All-llahu subhanehu ve teal, ia fal atij. Po ashtu, mund të shfaqet në zemrën e tij diç që karakterizon nifakun, por All-llahu subhanehu ve teal, ia largon atë. Besimtari sprovohet me vesveset-intrigat e shejtanit dhe me vesveset e kufrit të cilat ia ngushtojnë gjoksin atij, sikurse thanë sahabët : “O i Dërguar i All-llahut, subhanehu ve teal! Ndonjëri nga ne gjen diç të tillë në shpirtin e tij që sikur te binte nga qielli në tokë do të ishte më mirë për të se sa të flas atë gjë! Ai tha : “Një gjë e tillë është sinqeriteti i imanit” , d.m.th. ndodhja e asaj vesveseje, urrejtja e madhe ndaj saj dhe largimi i saj nga zemra, është sinqeritet i imanit.

Për pjesëtarët e nifakut të madh All-llahu, subhanehu ve teal, thotë:

“(Mbesin në errësirë) Të shurdhër, memecë, dhe të verbër, andaj ata nuk kthehen (nuk largohen nga rruga e tyre)” (El-Bekare: 18). d.m.th:nuk i kthehen islamit me bindjen e tyre të brendshme. Gjithashtu thotë:

“A nuk e shohin ata se për çdo vit sprovohen një apo dy herë dhe prapë ata nuk pendohen e as nuk marrin mësim” (Et-Tevbe: 126).

Dijetar i famshëm Ibnu Tejmije tha : “Dijetaret ranë ne dilemë e pranohet pendimi i tyre ne formën e jashtme, kur dihet se ata përgjithmonë shprehin islamin haptas.

Sqarimi i realitetit të çdo njërës nga El-xhahilije, El-fisku, Ed-dalal dhe Err-rridde

Llojet edhe dispozitat e tyre:

1) El-xhahilije (Xhahiljeti, injoranca, koha e injorancës)

Është gjendja në te cilën ishin arabët para islamit, që nuk e njihnin All-llahun, subhanehu ve teal, profetët e Tij, ligjet e fesë si dhe krenaria që kishin për fisin, mendjemadhësia, mizoria dhe shumë të tjera .

El-Xhahilije d.m.th. injorancë, është mos dija dhe mos ndjekja e diturisë. Dijetari i famshëm Ibnu Tejmija tha: “Nëse njeriu nuk e din të vërtetën, injoranca e tij është e thjeshtë, e nëse beson diç të kundërt me te vërtetën, injoranca e tij është dyfishtë, e nëse thotë te kundërtën e te vërtetës duke e njohur te vërteten apo duke mos e njohur atë, prapë është injorant. Nëse këtë e kuptojmë, atëherë shohim se njerëzit para Muhammedit, s.a.v.s, ishin ne

inJORANCë qe i përket mos dijes. Fjalët te cilat ata i thonin dhe veprat të cilat i kryenin ua shpiku një inJORANT. Gjithashtu, çdo gjë që është në kundërshtim me atë qe ju shpall profetëve sikurse është rasti me hebreizmin edhe krishterimin, është xhahilijjet. Ky është xhahilijjeti i përgjithshëm (në te gjithë boten), kurse pas Muhammedit, s.a.v.s , ai mund te ekzistoj ne disa vende e ne disa jo, sikurse është rasti me Daraul-Kufrin (vendet joislame). Gjithashtu, ai mund të gjendet tek një person e tek një tjetër jo, sikurse është rasti me njeriun para se te hyn ne islam, ai është në Xhahilijjet edhe nëse jeton ne Darul-Islam—in (vendet islame). Pas dërgimit te Muhammedit, s.a.v.s, nuk ka xhahilijjet te përgjithshëm (qe përfshin tërë boten), sepse një grup i ummetit të tij do te vazhdojnë të jenë në të vërtetën haptazi deri në Ditën e Kijametit. Kurse xhahilijjeti i kufizuar mund të ekzistojë në disa vende islame dhe ne shumë persona muslimanë, sikurse tha Muhammedi s.a.v.s: “Katër gjëra në ummetin tim janë, prej Xhailijetit“, dhe i tha Ebu Dherrit : “Ti je një njeri që në vete ke xhahilijjet”.

Paraqitje e shkurtër e gjithë kësaj :

Xhahilijjeti i përket inJORANCës, e cila është mosdija dhe ai ndahet në dy pjesë:

1) Xhahilijjeti i përgjithshëm përfshin periudhën para Muhammedit ,s.a.v.s, periudhën ndërmjet Isait e Muhammedit , s.a.v.s ,dhe ka marr fund me dërgimin e tij.

2) Xhahilijjeti i veçantë, i kufizuar:përfshin shumë shtete, vende dhe persona. Ky xhahilijjet ekziston gjithmonë .

2) El-Fisku (*mos respekti dhe mosbindja ndaj urdhërave të All-llaut*)

Kuptimi gjuhësor i fjalës El-Fisku është dalje apo zhveshje. Kurse në terminologjinë islame d.m.th: Dalje nga bindja e All-llahut xh.sh, mos respekti i Tij. Ai përfshin daljen e tërësishme, kështu që i thuhet pabesimtarit “Fasik” dhe përfshin daljen e pjesërishtme, kështu që i thuhet besimtarit, vepruesit të gjynaheve të mëdha “fasik”. Fisku që largon nga mileti islam i cili është mosbesim. Pabesimtari në këtë kuptim quhet “fasik”. All-llahu, subhanehu ve teala, kur përmendi Iblisin tha: “*...ai nuk respektoj urdhrin e Zotit te tij ...*” (El-Kehf:50), ky fisk i tij ishte mosbesimi nga ai. Gjithashtu All-llahu, subhanehu ve teala , tha :

“... kurse ata qe benë fisk (nuk respektuan urdhrat e Zotit) vend te tyre kanë zjarrin” (Es-Sexhde: 20), ka për qëllim pabesimtarët, këtë e argumenton vet ky ajet:

“Sa herë që ata dëshirojnë të dalin nga aty (zjarri) rikthehen prapë në të dhe u thuhet shijojeni dënimin e zjarrit të cilin ju e përgënjeshtrojnë”. (Es-Sexhde: 20). Mëkatari musliman quhet “Fasik” dhe ky fisk i tij nuk e largon atë jashtë Islamit. All-llahu subhanehu ve teala, thotë:

“Edhe ata që bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t’i rrahni ata me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u pranoni dëshminë kurrë më. Të tillë janë fasikët (të prishurit e të dalurit nga urdhrat e All-llahut)” (En-Nur:4), dhe tha:

“Haxhi është në muajt e caktuar e kush bën (ia fillon të zbatojë) haxhin në këtë muaj, nuk duhet afruar gruas, nuk bën të merr nëpër këmbë dispozitat e sheriatit (nuk bënë të bëj fisk), as nuk duhet shkaktuar grindje” (El-Bekare: 197).

Dijetaret gjatë komentit të “Fiskut” në këtë ajet thanë se janë gjynahet.

3) **Ed-dalal (humbja, shmangia)**

Ed-dalal : shmangia nga rruga e drejtë, është e kundërta e udhëzimit. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“Ai që udhëzohet, udhëzohet për vete edhe ai që devijon, devijon për vete” (El-Isra: 15)

Fjala Ed-Dalal shprehet në disa kuptime:

- 1) Ndonjëherë ka për qëllim mosbesimin. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:
“Ai që mohon All-llahun, melaqet e Tij, Librat e Tij, profetët e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai veç ka humbur me një humbje të madhe”. (En-Nisa: 136)
- 2) Ndonjëherë ka për qëllim shirkun (Politeizmin). All-llahu subhanehu ve tealë, thotë:
“...ai që i bën shirk All-llahut, veç ka humbur në një humbje të madhe” (En-Nisa: 116).
- 3) Ndonjëherë ka për qëllim kundërshtimet të cilat janë nën pozitën e kufrit (mosbesimit), sikurse thuhet: sektet devijuese, d.m.th. kundërshtuese
- 4) Ndonjëherë ka për qëllim gabimin, sikurse është rasti me thënien e Musait, a.s:
“Unë e bëra veprën time (vrasjen e njërit nga njerëzit e Faraonit) atëherë kur unë isha nga te humburit” (Esh-Shuara: 20).
- 5) Ndonjëherë ka për qëllim harresën, sikurse është fjala e All-llahut xh.sh:
“...për atë se nëse njëra prej tyre (grave që bëjnë dëshmi) humbë (gabon), le t’ia përkujton tjetra” (El-Bekare: 282).
- 6) Ndonjëherë ka për qëllim gjërat e humbura, në gjuhen arabe thuhet: dal-letul-lbili (Deveja e humbur).

4) **Err-rridde (braktisja, dalja nga islami)**

a) Dispozitat e saj

Err-rridde-tu në gjuhen Arabe ka kuptimin e kthimit. All-llahu, subhanehu ve tealë thotë:

“...mos u ktheni mbrapa...” (El-Maide: 21), kurse në terminologjinë e fikhut: Është dalja nga Islami dhe hyrja në mosbesim. All-llahu subhanehu ve tealë thotë :

“Ai që kthehet në mesin tuaj nga feja e tij dhe vdes ashtu duke qenë pabesimtarë të këtyllë janë ata që u janë shkatërruar veprat e tyre në dynja dhe në ahiret dhe ata janë banorët e zjarrit ku do të qëndrojnë përgjithmonë” (El-Bekare: 217).

b) Llojet e saj

Err-rridde-tu ndodhë me veprimin e ndonjërës nga Zhvleftësueset e Islamit (nevakidul-islam). Nevakidul-islam (zhvleftësueset e islamit)janë të shumta, ato bashkohen në katër lloje:

1) Err-rridde-tu (dalja nga islami) me fjalë: sikurse janë p.sh: sharja e All-llahut subhanehu ve tealë, e Muhammedit, s.a.v.s, e melaqeve, e profetëve, pastaj pretendimi për njohjen e Gajbit (fshehtësisë), pretendimi i shpalljes apo besimi në personin që pretendon atë, falja (lutja) për dikë tjetër përveç All-llahut, kërkimi i ndihmës nga dikush për diç që mund ta bëj vetëm All-llahu subhanehu ve tealë, apo kërkimi i strehimit tek ai

2) Err-rridde-tu me vepër: sikurse është sexhdeja për idhullin, drurin, gurin, varret dhe therja në emër të tyre dhe për to. Hedhja e Kur'anit në vende të ndyta, marrje me magji, mësimi dhe arsimimi i saj dhe mos gjykimi me shpalljen (Kur'anin, ligjet) e All-llahut subhanehu ve tealë, duke besuar lejimin e ndonjë gjykimi të tillë (te disa dijetarë ai që nuk gjykon me Kur'an, ka dal nga islami, pa marr parasysh besimin e lejimit apo të mos lejimit).

3) Err-rridde-tu në besim: sikurse është besimi se Zoti ka shok-shirku, besimi se si prostitucioni, alkooli dhe kamata janë të lejuara ose besimi që buka është e ndaluar ose që namazi nuk është obligim dhe ngjashëm me këto që dihen se janë hallall apo haram me argumente të prera.

4) Err-rridde-tu me dyshim në diç që u cek më parë: Sikurse është p.sh. dyshimi në ndalimin e shirkut, prostitucionit ose alkoolit, ose dyshimi se buka është e lejuar ose dyshimi në shpalljen e Muhammedi, s.a.v.s, apo shpalljet e profetëve të tjerë ose dyshimi në vërtetësinë e Muhammedit, s.a.v.s, apo te fesë Islame dhe dyshimi në vlefshmërinë e saj për të gjitha kohërat.

Dispozitat që pasojnë pas vërtetimit të ndodhjes së Err-rriddes

1) Pendimi i murtedit (dezertuesit nga feja) nëse ai pendohet dhe rikthehet në Islam brenda tri ditëve i pranohet pendimi dhe lihet i lirë.

2) Nëse refuzon të pendohet është obligim vrasja e tij, duke u bazuar në fjalën e Muhammedit, s.a.v.s: *“Ai që ndryshon fenë e tij (Islamin) vriteni”*

3) I ndalohet përdorimi i pasurisë së tij gjatë kohës kur kërkohet nga ai të pendohet, nëse pendohet pasuria i mbetet atij, e nëse nuk pendohet ajo pasuri dërgohet në “shtëpinë e pasurisë së Muslimanëve” bejtul-malil muslimin) që nga vrasja apo vdekja e tij. Disa dijetarë thonë se ajo i merret atij qysh me ndodhjen e rridde-s nga ai .

4) Shkëputja e trashëgimisë mes tij dhe mes të afërmeve të tij, ky nuk i trashëgon ata dhe as ata nuk e trashëgojnë këtë.

5) Nëse vdes ose vritet gjatë rriddes së tij, nuk lahet e as nuk i falet xhenazja e as nuk varroset në varrezat e muslimanëve, por varroset në varrezat e pabesimtareve apo kudo tjetër jashtë varrezave të muslimanëve.

Kapitulli II

Disa fjalë dhe vepra të cilat e kundërshtojnë tevhidin apo e pakësojnë atë

Pretendimi i njohjes së diturisë së fshehtë përmes leximit të shuplakës e të filxhanit dhe të ngjashme

Gajbi

Gajb (fshehtësi) është çdo gjë nga e ardhmja, e kaluara që është e fshehur për njerëzit dhe ajo që njerëzit nuk e shohin. All-llahu, subhanehu ve teala: atë e veçoj për Vetën. Ai thotë: *“Thuaj (Muhammed): askush në qiej dhe në tokë nuk e din të fshehtën përveç All-llahut”*. (En-Neml : 65). Pra, fshehtësinë nuk e din askush përveç All-llahut, subhanehu ve teala. Por, Ai mund t’ia bëj atë të njohur profetëve të Tij, për shkak të ndonjë urtësie apo dobie. Ai thotë: *“Njohësi i fshehtësisë, e atë nuk ja zbulon askujt, përveç ndonjë profeti që Ai e zgjodhi...”* (El-Xhinn: 26-27), d.m.th. Ai nuk ia bën atë të njohur askujt përveç atij që e zgjodhi për shpalljen e Tij, kështu që i zbulon atij çka të dojë nga fshehtësia e Tij. Dhe kjo, për arsye se ai profet argumenton shpalljen me mrekulli, e që nga ato është: Rrëfimi i fshehtësive të cilat All-llahu ia zbulon. Ky zbulim përfshin të dërguarin nga melaqet e nga njerëzit dhe askënd tjetër. Pra ai që pretendon se di fshehtësinë, me çfarëdo metode qoftë, përveç profetëve që All-llahu xh.sh. i zgjodhi vet, ai është gënjeshtarë dhe pabesimtar pa marr parasysh se a e bën përmes leximit të shuplakës, filxhanit, fallit, magjisë, astronomisë etj. Kjo është ajo që ndodhë me disa të prishur dhe gënjeshtarë të cilët tregojnë vendin e gjërave të humbura e të fshehura ose tregojnë shkaqet e disa sëmundjeve, e thonë: filani ta bëri këtë dhe u sëmurë për këtë shkak. Kjo, në realitet, ndodhë sepse atyre u shërbejnë xhinët dhe shejtanët, ndërsa të njerëzit paraqiten kinse i bëjnë më veprimin e atyre gjërave duke tentuar kështu mashtrimin dhe tradhtinë e tyre. Dijetari i famshëm Ibnu Tejmie tha: “Falltorët kishin me vete shok nga shejtanët, të cilët u lajmëronin për shumë fshehtësi nga dëgjimet që i vidhnin ata, pastaj ata përzienin të vërtetën me gënjeshtër... disa falltorëve shejtanët u bien ushqime, pemë dhe ëmbëlsira etj që nuk gjinden në atë vend kurse disa nga ata xhini i bartë (duke fluturuar) deri ne Mekë, Mesxhidul-aksa apo diku tjetër”.

Lajmet e tyre mund të ndodhin edhe me anë të astrologjisë dhe yjeve. (Tënxhimi është argumentimi me ndodhi tokësore me anë të ndryshimeve astronomike, sikur se kohët e ngritjes së erërave, rënies së shiut, ndryshimit të çmimeve dhe çështjeve të tjera për të cilat mendojnë se mund të dihen me anën e udhëtimit të planetëve nëpër shtigjet e tyre, me anë të bashkimit dhe ndarjes së tyre). Ata thonë: ai që martohet me filan ylli, i ndodh kjo ose ajo ngjarje, ai që udhëton me filan ylli, i ndodh filan ndodhia, ai që lindë në filan yllin ndodh filan puna e gëzuar apo e shëmtuar sikurse publikohen thashethemet horoskopike nëpër disa gazeta të prishura.

Disa njerëz injorant dhe me iman të dobët shkojnë tek ata astrolog dhe i pyesin për ardhmërinë e tyre se çka do të ndodhë, i pyesin për martesën e tyre etj. Ai që pretendon njohjen e fshehtësisë apo ai që i beson ati që pretendon një gjë të tillë është mushrik dhe

pabesimtarë, dhe kjo është për arsye se ai i bën shirk (shoqërim) All-llahut, subhanehu ve tealë, në atë që është e veçantë vetëm për të. Yjet janë të krijuara e të nënshtruara, nuk kanë në dorë asgjë dhe nuk sinjalizojnë ndonjë gëzim e as ndonjë pikëllim dhe as ndonjë vdekje, apo lindje. E gjithë kjo, në realitet, ndodhë nga veprimet e shejtanëve të cilët mundohen t'i vjedhin fjalët nga qiejt lartë (Kur melaqet flasin).

Magjia (Es-Sihru), Falli (el-kehane) dhe Profetizmi (el-arrafe)

Të gjitha këto çështje janë veprime të shejtanëve dhe janë të ndaluara. Ato kundërshtojnë akiden (besimin) sepse ato nuk arrihen përveç se me veprime politeiste.

a) Magjia

Është një veprim i letë dhe i fshehtë që nuk i dihet shkaku (në sytë e njeriut); Është quajtur magjia në gjuhën arabe "es-sihru", sepse ajo ndodh në mënyrë të fshehtë që nuk kapet me sy. Ajo është thirrje, fryerje, fjalë që fliten, lutje dhe tymosje (ted'hinat). Magjia ndodhë në realitet (është hak), disa nga ato ndikojnë në zemër dhe në trup, kështu që njeriu sëmuret, vret dhe ndahet gruaja nga burri i saj. Ky ndikim i magjive ndodhë me lejen dhe caktimin e Kevni (kosmologjik) të All-llahut, subhanehu ve tealë. Ato janë veprime djallëzore dhe shumica e tyre nuk arrihen përveç se me shirk dhe afrim tek shpirtat e këqij përmes veprimeve që ata dëshirojnë. Për këtë arsye, Muhammedi, s.a.v.s, e bashkojë sihrin me shirkun kur tha: "Largojuni shtatë shkatërruesve", i thanë (shokët): cilat janë ato? Tha: t'i bësh shoqërim All-llahut (shirku), magjia (sihri) ..."

Magjia hyn brenda shirkut nga dy aspekte

Aspekti i parë: për shkak të shërbimit të shejtanëve, lidhjes me ta dhe afrimit tek ata me ato veprime që ata i dëshirojnë dhe në këtë mënyrë i shërbejnë ata magjistarit. Pra, sihri është edukim i shejtanëve, All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

"Por shejtanët e mohuan, ata u mësojnë njerëzve sihrin ..." (El-Bekare : 102)

Aspekti i dytë: Sepse sihri është pretendim i njohjes së fshehtësisë në këtë aspekt. Një gjë e tillë është kufr dhe devijim, All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë: "...ata veç e dinë se ai që e blenë atë(e përdorë sihrin) në ahiret nuk ka asnjë pjesë" (El-Bekare: 102). Nëse sihri është i tillë atëherë nuk ka dyshim se ai është kufr dhe shirk, i cili kundërshton akiden (besimin islam) dhe është obligim vrasja e atij që merret më të, sikurse vranë sahabet disa nga ata magjistarë. Disa njerëz u treguan dorëllirë ndaj sihrit dhe sihirbazeve, sa që disa nga ata e llogariten atë me art me të cilin lavdërohen e marrin dhuratat e lavdërime. Në disa vende organizohen mbledhje dhe gara të veçanta ku prezantojnë sihirbazët dhe mijëra argëtues. Kjo është mosnjohje e fesë (xhahilijet), mospërfillje e besimit dhe hapje e dyerve para njerëzve të prishur.

b) Falli (El-kehanetu) dhe profetizmi (El-arrafe)

Ato janë pretendimi i njohjes së fshehtësisë dhe çështjeve të fshehura sikurse janë lajmërimet që çka do të ndodh mbi tokë dhe ku është vendi i gjësendit të humbur me ndihmën e shejtanëve të cilët vjedhin zërat nga qielli. All-llahu, subhanehu ve tealë thotë:

“A t’iu lajmëroj se kujt i zbresin shejtanët!? Ata i zbresin çdo të prishuri edhe gjynahqarit të madh. Ata (shejtanët) i hedhin dëgjimet (se çka flasin melaqet) por shumica e tyre gënjejnë.” (Esh-Shuara: 221-223), kjo ndodhë kur shejtanët vjedhin ndonjë fjalë të melaqeve dhe pastaj e vënë në veshin e falltorit dhe nga kjo rren ai shpif njëqind gënjeshtër dhe njerëzit i besojnë për shkak të asaj fjale që e ka dëgjuar nga qielli. Vetëm All-llahu subhanehu ve teala, është njohësi i fshehtësisë, kurse ai që pretendon shoqërimin e Tij në këtë çështje apo i beson personit që pretendon një gjë të tillë, i ka bërë shirk All-llahut, subhanehu ve teala, në atë që është e veçantë për Të. Falli nuk është i pastër nga shirku, sepse ai është afrim tek shejtanët me ato veprime që ata i dëshirojnë. Falli është shirk në rrububijetin e All-llahut, subhanehu ve teala, (hyjninë e Tij), sepse vepruesi i Tij pretendon shoqërimin e All-llahut subhanehu ve teala, në diturin e Tij. Gjithashtu, falli është shirk në uluhijetin e All-llahut, subhanehu ve teala ne adhurimin e veçantë për All-llahun, subhanehu ve teala, sepse ai është adhurim i shejtanëve . Transmetohet nga Ebu Hurejra ,radijallahu anhu, se Muhammedi s.a.v.s, tha : “Ai që shkon tek një falltor dhe i beson ati, ai vetëm se ka mohuar atë që iu zbrit Muhammedit”.

Çështja në të cilën duhet të pasur kujdes dhe duhet këshilluar te tjerët është se: Se magjistarët dhe falltorët luajnë me besimet e njerëzve, sepse u paraqiten atyre me rroba të mjekëve kështu që i urdhërojnë të sëmuret që t’i bëjnë kurban dikujt tjetër përveç All-llahut subhanehu ve teala, u thonë të therin dashin apo pulën me filan cilësi apo u shkruajnë atyre hajmali (nuska), që përmbajnë shirk dhe nuska djallëzore në formë të hajmalive që ju vejnë në qafë apo në shtëpitë e tyre. Disa nga ata paraqiten në formë të atyre që lajmërojnë fshehtësinë dhe vendin e gjërave të humbura. Injorantët shkojnë tek ata dhe i pyesin për gjera të humbura, kurse këta i lajmërojnë apo ua bëjnë gjerat të humbura përmes bashkëpunëtorëve të tyre në mesin e shejtanëve. Disa te tjerë nga ata paraqiten në formën e evliave, të cilët kinse bëjnë mrekulli e keramete , sikurse është p.sh. hyrja në zjarr pa e djegur zjarri atë, rrahja e vetes me armë, hyrja e tij në rrotat e makinës pa e dëmtuar atë apo veprimet tjera, të cilat në realitet janë sihr dhe veprime të shejtanëve që i bëjnë me dorën e falltorëve që në këtë mënyrë të bëjnë trazira në mes njerëzve apo ato janë çështje imagjinare – fikson e jo realitet .Ato janë mashtrime të fshehta të cilat i veprojnë ata vetëm t’u paraqiten ashtu para syve të njerëzve, sikurse ishin veprimet e magjistarëve të Faraonit, kur litarët e tyre kinse u shndërruan në gjarpërinj. Dijetari i famshëm Ibnu Tejmije, në dialogun e tij me magjistaret e sekti betaihije El-Ahmedije (te sekti rifaije) tha, pasi që shehi i tyre i tha këtij dhe kishte ngritur zërin: “Neve an ndodhin filan e filan ndodhi”. Ai pretendoj se bëjnë mrekulli, sikurse është veprimi i tyre me zjarrin dhe veçimi i tyre me të, e për këtë arsye duhet heshtur para tyre. Thotë Ibnu Tejmie: “Thashë, i ngrita zërin dhe u hidhërova: Unë i drejtohem çdo rifaije prej lindjes së diellit e deri në përfundim të tij që edhe unë do të bëjë më zjarrin çdo gjë që ata veprojnë me të, e ai që digjet ka pësuar disfatë, apo nëse nuk harrova thashë: Ai që digjet qoftë mallkimi i All-llahut, subhanehu ve teala, me të. Por një gjë të tillë do ta bëjmë pasi që ta lajmë trupin tonë me uthull dhe ujë të nxehtë. Atëherë, më pyeten udhëheqësit dhe njerëzit (që ishin aty) për këtë, u thashë: sepse ata bëjnë mashtrime në bashkimin e tyre me zjarrin, ata bëjnë një material nga yndyra e bretkosave, lëvoret e portokajve dhe guri i zjarrit.

Kur njerëzit dëgjuan këtë u mahnitën. Ai (shehi) filloi të paraqitet kinse në realitet ka mundësi të tillë, e tha: Unë dhe ti do të lidhemi për një guri pasi që trupat tonë të jenë lyer me squfur . I thashë : ngrihu pra! Fillova ta thërras që ai ta bëjë një gjë të tillë. Ai zgjati duart e tij duke u paraqitur se do ta zhveshin këmbët e tij. I thash: një gjë të tillë nuk do ta bësh para se të lahesh me ujë të nxehtë dhe uthull. Ai u paraqit kinse nuk kuptoi sikurse e kanë shprehur gjithmonë, e tha: ai që e donë emirin (udhëheqësi që ishte prezent) le të mbledh drunj. I thash: kjo që thua është e tepërt dhe përçarje e tubimit dhe nuk arrihet qëllimi, por, mjafton të sjellët një kandil i ndezur, pastaj unë dhe ti i fusim në të gishtërinjtë pas larjes së tyre, atij që t'i digjet gishti qoftë mallkimi i All-llahut me të apo i thashë: ka pësuar disfatë. Kur ja thashë këtë ai ndryshojë dhe tregoi nënshtrimin e tij”. Ibnu Tejmie ka për qëllim të tregoj se ata gënjeshtarë i mashtrojnë njerëzit më gjëra të tilla

Prezentimi i kurbanave, zotimeve dhe i dhuratave të tyrbet e varrezat dhe madhërimi i tyre

Muhammedi, s.a.v.s, mbylli të gjitha dyert të cilat shpion deri të shirku dhe tërhoqi vërejtjen nga ai deri në maksimum. Në mesin e tij përmendi edhe çështjen e varrezave. Ai caktoi parimet mbrojtëse nga adhurimi i tyre dhe kalimi i kufirit ndaj të varrosurve, në mesin e atyre parimeve janë:

1) Ai qortoj në respektin e tepërt të ndaj evliave dhe njerëzve të mirë sepse një gjë e tillë shpion deri tek adhurimi i tyre, e tha: “Ruajuni teprimi sepse ata që ishin para jush (Hebrejt dhe të krishterët) i shkatërroj teprimi” dhe tha: “Mos me ngritni mua sikurse e ngritën të Krishterët birin e Merjemës (Isaun alejhis selam), unë jam vetëm një rob, pra thuani: Robi i All-llahut dhe i dërguari i Tij” .

2) Gjithashtu, ai na këshilloj që mos të ndërtohet mbi varre, sikurse transmeton Ebul-Hejjaxh El-Esediu, i cili thotë: më tha mua Aliu r.a: “A të dërgoi (dërgues) ashtu sikurse me dërgoj mua i dërguari i All-llahut!? Që mos ta lësh asnjë përmendore pa e rrezuar dhe të mos lësh as një varr të ngritur pa e rrafshuar”. Po ashtu, ai ndaloj lyerjen e tyre dhe ndërtimin mbi to. Xhabiri radiAll-llahu anhu, thotë: I dërguari i All-llahut ndaloj lyerjen e varrit, uljen dhe ndërtimin mbi të

3) Ai na këshilloi, gjithashtu, që mos të falemi në varreza. Transmeton Aisheja, radiAll-llahu anha , tha: kur u sëmur i dërguari i All-llahut filloj ta hedhë një gunë të tij që e kishte mbi fytyrën e tij, e kur pikëlluhej e shpaloste. Duke qenë në këtë gjendje ai tha: “mallkimi i All-llahut qoftë mbi hebrejt dhe të krishterët, të cilët i bënë varrezat e profetëve të tyre mesxhide (Xhamia ku u bënë sexhde). Ai gjithashtu tha: vëni re ata që ishin para jush (hebrejt dhe krishterët) i bënë varrezat e profetëve të tyre Xhamia. Ju mos i bëni varrezat xhamia, sepse unë iu ndaloj një gjë të tillë. Nga ky hadith kuptohet se nuk bënë të falesh të varrezat edhe nëse nuk ka xhamia tek ato, sepse çdo vend që bëhet për qëllim të faljes llogaritet mesxhid, sikurse tha Muhammedi, s.a.v.s: E gjithë toka më është bërë (më është lejuar për falje) xhami dhe e pastër”. E nëse në varreza ndërtohet xhamia, ndalimi është edhe me i ashpër. Shumica e njerëzve i kundërshtuan këto ndalime të Muhammedit, s.a.v.s, dhe

nuk i përfillen ato dhe ranë në shirkun më të madh. Kështu që ndërtuan mbi varreza xhamia dhe shumë tyrbe. Ato tyrbe dhe varreza i bënë vende ku praktikohen të gjitha llojet e shirkut të madh si prerja për to, lutja dhe kërkimi i ndihmës nga te varrosurit dhe gjëra të tjera. Dijetari i famshëm Ibnul- Kajjim (All-llahu, subhanehu ve teala, e mëshiroftë) tha: “ai që shikon situatën në mes te Sunnetit te Muhammedit, s.a.v.s, rreth varrezave dhe atë që ai e urdhëroi dhe e ndaloi me gjendjen në të cilën ishin shokët e tij dhe gjendjen në të cilën gjenden njerëzit sot, do të vërejë një kundërshtim dhe dy pole të kundërta që nuk bashkohen kurrë. Muhammedi, s.a.v.s, ndaloi faljen tek varrezat kurse njerëzit sot mu aty falen. Ai ndaloi ndërtimin e xhamive mbi varreza, kurse ata ndërtojnë mbi to xhamia dhe i quajnë “meshahid”, duke tentuar kështu t’i imitojnë shtëpitë e Zotit. Muhammedi ,s.a.v.s, ndaloi ndezjen e qirinjve tek ato, ata i ndezin qirinjtë aty, ai gjithashtu, ndaloi të bëhen festat aty, ata i bëjnë festat aty dhe tubohen më shumë se sa për festën e Bajramit. Muhammedi ,s.a.v.s, urdhëroi të rrafshohen varrezat, sikurse e cekëm më parë thënien e Aliut, radiall-llahu anhu, kurse ata e teprojnë në kundërshtimin e ndalimit të Muhammedit, s.a.v.s, dhe i ngritin ato pors i shtëpitë dhe u vendosin lart kube ... shiko, pra, këtë dallim të madh në mes të asaj që urdhëroi Muhammedi, s.a.v.s, dhe pati për qëllim me ndalimin e tij që cekëm për varrezat dhe në mes të asaj që bëjnë njerëzit.

Nuk ka dyshim se ato veprime kanë dëme të shumta që nuk mund t’i numërojmë ...në realitet Muhammedi, s.a.v.s, urdhëroi që vizita e varrezave ta përkujtojë ahiretin, t’i bësh dua atij që e viziton, të kërkosh nga All-llahu subhanehu ve teala, falje dhe shpëtim për të. Me këtë rast, vizituesi i bën dobi vetes dhe të varrosurit. Kurse ata politeistë, e rrotulluan çështjen dhe fenë, kështu që me vizitën e varrezave bën për qëllim të tyre shirkun, dukë i lutur të varrosurit t’u përgjigjen nevojave të tyre dhe t’i bëjnë të begatshëm, kërkojnë ndihmë nga ata kundër armikut dhe të ngjashme. Me këtë rast ata i bëjnë dëm vetes dhe të varrosurit”. Nga kjo bëhet e qartë se bërja e zotimeve dhe therja e kurbaneve tek varrezat është shirk i madh, sepse një gjë e tillë është në kundërshtim me rrugën e Muhammedit ,s.a.v.s, dhe gjendjen në të cilën duhet të jenë varrezat. Ai udhëzon që të mos ndërtohen xhami në to, sepse kur mbi to u ndërtuan tyrbet, kubet dhe xhamitë menduan injorantët se të varrosurit aty mund t’iu bëjnë dobi dhe dëm, si dhe mund t’i përgjigjen atij që kërkon ndihmë, kështu që njerëzit filluan t’iu bëjnë kurban derisa u bën ato varreza idhuj që adhurohen përveç All-llahut, subhanehu ve teala . Muhammedi,s.a.v.s, tha:

“O Zot! Mos e bë varrin tim idhull që adhurohet”. Ai këtë lutje e bëri, sepse e dinte se si në varrezat tjera do të ndodh një gjë e tillë. Kjo është edhe duke ndodhur ne shumë vende islame, kurse varri i tij, s.a.v.s, është i mbrojtur me bereqetin e lutjes së tij, edhe pse ndonjëherë afër varrit të tij ndodhin disa gabime nga disa injorantë apo devijues. Por, ata nuk mund të arrijnë tek varri i tij, sepse varri i tij është në shtëpinë e tij e jo ne xhami dhe është rrethuar me tri mure sikur se thotë Ibnul-Kajjimi: Zoti i botëve ju përgjigj lutjes së tij dhe rrethoj atë me tri mure .

Sqarimi i dispozitës rreth madhërimit të statujave dhe përmendoreve përkujtuese

Et-Temathil (statujat): Janë statuja trupore në formë të njeriut, të shtazës apo ndonjë gjëje tjetër që ka shpirt .

En-nusub (përmendoret) në thelb janë:Flamujt dhe gurët të cilët politeistët i gdhendin në formë të ndonjë udhëheqësi apo njeriu të madh që kështu ta ringjallin përkujtimin e tyre. Muhammedi, s.a.v.s, na këshilloi që të mos vizatojmë gjërat që kanë shpirt, e posaçërisht vizatimin e atyre që madhërohen në mesin e njerëzve, sikurse janë dijetarët, mbretërit, mistikët, udhëheqësit dhe paria. Pa marrë parasysh se a bëhet ky vizatim në ndonjë pllakë, letër, mur, rroba, apo përmes mjetit fotografues (apararit) që njihet në kohën tonë apo përmes gdhendjes dhe ndërtimit të fotografisë në formë të statujës. Muhammedi,s.a.v.s, ndaloi vënien e fotografive në mur e ngjashëm me të, si dhe ruajtjen e statujave e të përmendoreve dhe vënien e tyre ne shtëpi për përkujtim, sepse një gjë të tillë është rrugë deri te shirku. Shirku i parë që ndodhi mbi fytyrën e tokës ndodhi si shkak i vizatimeve dhe përmendoreve. Në popullin e Nuhit, alejhis-selam, jetonin disa njerëz të mirë, kur ata vdiqën , populli filloj te pikëllohet për ata, atëherë, shejtani u shpalli atyre që t’u ndërtojnë atyre statuja në mexhliset ku ata rrinin dhe t’u vënin atyre statujave emrat e tyre. Në fillim ato statuja nuk adhuroheshin, por, kur kaloi kjo gjeneratë dhe u harru dituria, ata filluan t’i adhurojnë ato statuja. Pastaj, All-llahu, subhanehu ve teal, dërgoi Nuhin, alejhis-selam, që t’i largoi ata nga shirku që ndodhi si shkak i atyre statujave, ata nuk iu përgjigjën dhe këmbëngulën në adhurimin e atyre statujave, të cilat ishin shndërruar në idhuj: *“Dhe u thanë: Mos braktisni zotat tuaj kurrsesi, mos braktisni Veddan, e as Suvvanë, e as Jeguthin, Jeukën e Nesrenë”* (Nuh: 23).

Këta janë emrat e atyre burrave të cilëve u ndërtuan statujat në formën e tyre që të ringjallet përkujtimi i tyre. Shiko, pra, se deri ku arriti çështja si shkak i atyre statujave përkujtuese përmes të cilave njerëzimi ra në shirk dhe në kundërshtim të All-llahut, subhanehu ve teal, e të dërguarve të Tij. Ky ishte shkak që All-llahu, subhanehu ve teal, i shkatërrojë ata me përmytje (tufan) dhe i bëri të urreyer te All-llahu, subhanehu ve teal, dhe te njerëzimi. Kjo tregon se sa i rrezikshëm është vizatimi dhe formimi i statujave, për këtë arsye Muhammedi, s.a.v.s, i mallkojë skulptorët dhe tha se ata kanë dënimin me të ashpër në Ditën e Gjykimit. Ai urdhëroj largimin e fotografive dhe na tregojë se melaqet nuk hynë në shtëpi ku ka fotografi. Të gjitha këto ai i tregojë për shkak të keqbërjes dhe rrezikut të madh të tyre për besimin e ummetit të Tij. Pra shirku i parë në tokë ndodhi nga ato statuja, atëherë, ato janë të ndaluara, sepse, janë rrugë deri tek shirku, dhe shkatërruese të besimit, dhe pa marrë parasysh se a gjinden ato statuja në mexhlise, në sheshe apo në kopshte. Nëse pabesimtarët sot bëjnë punë të tilla pasi që ata nuk kanë besim (akide) që veprojnë sipas tij, muslimanëve nuk iu lejohet t’i imitojnë dhe t’i shoqërojnë ata në këtë veprim, sepse kështu ata do të mbrojnë besimin e tyre i cili është burimi i fuqisë dhe i lumturisë së tyre.

Sqarimi i dispozitës rreth përqeshjes me fenë dhe mos përfilljes së ndalimeve të saj

Përqeshja me fenë është largim nga Islami dhe dalje nga feja në përgjithësi. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“Thuaj (Muhammed) : “A me All-llahun, ajetet dhe të dërguarin e Tij ju ishit duke u përqeshur. Mos kërkoni falje, ju mohuat pasi që e kishit besuar”. (Et-Tevbe: 65-66). Ky ajet, argumenton se përqeshja me All-llahun, subhanehu ve tealë, me ajetet dhe të dërguarin e Tij është kufr, si dhe përqeshja me njërin nga këta është përqeshje me të gjithë. Ky ajet zbriti sepse munafikët (dyfytirshët) ishin përqeshur me Muhammedin, s.a.v.s, dhe me shokët e tij. Ata të cilët ulin njëshmërinë e All-llahut, subhanehu ve tealë, madhërojnë lutjen e të vdekurve dhe kur të thirren që të besojnë në një Zot e të ndalohen nga shirku, nuk ja vënë veshin asaj thirrje, të gjitha këto çështje janë përqeshje, sikurse thotë All-llahu, subhanehu ve tealë:

“Dhe kur ata të shohin ty (Muhammed) nuk të marrin parasysh përveç se përqeshin: ‘A ky është ai të cilin All-llahu e dërgoi profet!? Gati ishte ky të na largojë nga zotërat tanë sikur të mos ishim të qëndrueshëm ndaj tyre’. (El-Furkan: 41-42). Ata u përqeshën me Muhammedin, s.a.v.s, sepse ky i largonte ata nga shirku. Edhe sot e kësaj dite politeistët i fyejnë dhe i përshkruajnë profetët me mendjelehtësi, devijim dhe çmenduri për atëherë që ata thirrën në monoteizëm, këtë e bëjnë sepse ata madhërojnë në zemrat e tyre shirkun. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“Ka nga njerëzit të tillë që marrin përveç All-llahut idhuj, i duan ata sikurse duhet (nga besimtarët) All-llahu...” (El-Bekare: 165).

Ai që donë një krijesë sikurse All-llahun, subhanehu ve tealë, është politeist. Këtu duhet dalluar mes dashurisë për All-llahun, subhanehu ve tealë, dhe dashurisë sikurse All-llahun, subhanehu ve tealë. Ata të cilët bënë varrezat idhuj te tyre, përqeshën Njëshmërin dhe adhurimin e All-llahut, subhanehu ve tealë, dhe madhërojnë ndërmjetësuesit që i kanë marrë përveç Zotit, sa që ndonjëri nga ata mund të betohet rrejtshëm në All-llahun, subhanehu ve tealë, ndërsa një gjë të tillë nuk mund ta bëjë në emër të shehit të tij. Sekte të shumta e konsiderojnë se të lutesh dhe të kërkosh ndihmë nga shehi te varri i tij apo ne ndonjë vend tjetër është më i dobishëm se sa t'i lutesh All-llahut, subhanehu ve tealë në xhami në kohën e suhurit (para agimit). Ata përqeshen me atë që e la tarikatin (sektin) dhe kalon në rrugën e tevhidit. Disa nga ata i përqeshin e i prishin xhamitë kurse i ndërtojnë teqet. Një veprim i tillë a nuk është përqeshje me All-llahun, subhanehu ve tealë, ajetet dhe të dërguarin e Tij, kurse në anën tjetër, a nuk është madhërim i shirkut?!

Përqeshja me fenë ndahet në dy lloje

1) Përqeshje e hapët me fenë: Sikurse ndodhi me ata për të cilët zbriti ajeti, fjalët e të cilëve i ishin: Nuk kemi parë sikur këta shokët tanë (sahabët) më barkmëdhenj, e më gënjeshtarë, e më frikacak gjatë luftimit ose ngjashëm me fjalët e përqeshësve. Pastaj fjala e tyre: Kjo feja e juaj është fe e pestë, apo thënia: Feja e juaj është fe e budallenjve, apo thënia: erdhën fetarët (në mënyrë përqeshëse), kur i shohin ata që urdhërojnë në të mira dhe pengojnë nga të këqijat dhe shumë thënie të tjera që nuk mund t'i numërojmë, e të cilat janë

më të mëdha se sa të atyre për të cilët zbriti ajeti.

2) Përqeshja jo e hapët me fenë. Është det i pafund, sikurse është: Bërja me sy, nxjerrja e gjuhës, shtyrja me dorë gjatë leximit të Kur'anit, Sunetit të pejgamberit, gjatë urdhërimit në të mirë dhe pengimit nga të këqijat, kështu është edhe thënia e disave: Se Islami nuk vlen për shekullin e njëzetë, por ai vlen për shekujt e mesëm dhe ai është prapambetje dhe është i ashpër në dënimet e tij. Ai i bëri mizori gruas sepse lejoi shkurorëzimin e saj dhe lejoi poligaminë dhe thënia e tyre: Gjykimi me sistemet njerëzore është më i mirë është se sa gjykimi islam. Pastaj i thonë atij që thërret në monoteizëm dhe largon nga adhurimi i varrezave "ekstremist" ose "fundamentalist" ose së dëshiron të përçajë xhematin, se ai i takon medh'hebit të pestë. Dhe fjalë të ngjashme, të cilat në realitet janë fyerje e fesë, e fetarëve dhe përqeshje me besimin e vërtetë.

Ve la havle ve la kuvvete il-la bilah.

Kështu bëhet përqeshja me sunnetin e Muhammedit, s.a.v.s,

Mos gjykimi me ligjet e All-llahut, subhanehu ve teala

Nga detyrimet e imanit dhe të adhurimit të All-llahut, subhanehu ve teala është nënshtrimi ndaj gjykimit të Tij, gëzimi me ligjin e Tij dhe kthimi te Libri i Tij e te Sunneti i të Dërguarit të Tij gjatë kundërshtimeve në fjalë, në baza, në armiqësi, në gjakra, në pasuri dhe në të drejtat tjera. All-llahu subhanehu ve teala, është Gjykatësi dhe Atij i takon gjykimi. Atëherë udhëheqësit e kanë për detyrë të gjykojnë me ligjet e All-llahut, subhanehu ve teala të cilat i shpalli, kurse për popullin është obligim të kërkojnë gjykimin me ato ligje që Ai i zbriti në librin e Tij dhe në Sunnetin e të Dërguarit të Tij. All-llahu, subhanehu ve teala, për udhëheqësit thotë:

"Vërtet All-llahu, ju urdhëron juve që t'i kryeni amanetet (t'i ktheni ato) te pronarët e tyre dhe kur të gjykoni mes njerëzve të gjykoni me drejtësi..." (En-Nisa: 168); Kurse për popullin (të nënshtruarit) thotë:

"O ju që besuat! Bindjuni All-llahut dhe bindjuni të Dërguarit të Tij e edhe udhëheqësit në mesin tuaj (është fjala për udhëheqësit që gjykojnë me Librin e All-llahut, subhanehu ve teala). Nëse bini në kundërshtim rreth një gjëje kthehuni tek All-llahu (Libri i Tij) dhe tek i Dërguari i Tij (Sunneti i Tij) nëse besoni All-llahun, dhe Ditën e Gjykimit. Kjo është më hajr dhe kthim më i mirë". (En-Nisa: 59). Pastaj, Ai sqaroi se imani dhe mos gjykimi i me ligjet e All-llahut, subhanehu ve teala, nuk mund të bashkohen, e thotë;

"A nuk i sheh (Muhammed) ata të cilët supozojnë se besuan në atë që t'u zbrit ty (Kur'an) dhe në atë që zbriti para teje (librat e mëparshëm), e në të njëjtën kohë kërkojnë gjykim te taguti (është shejtani dhe çdo njeri që nuk gjykon me ligjet e All-llahut), kurse ata janë urdhëruar që ta mohojnë (shejtanin). Shejtani dëshiron që ata t'i humbë në një devijim të largët ." (En- nisa :60), deri te fjala e Tij:

"Jo, betohem në Zotin tënd! Ata nuk besojnë derisa mos të marrin ty për gjykatës në mosmarrëveshjet e tyre dhe pastaj në veten e tyre nuk do të ndjejnë kurrfarë pakënaqësie nga

grykimi yt dhe të dorëzohen plotësisht .” (En-Nisa:65).Pra, All-llahu, subhanehu ve tealë, me betim të fortë, mohoi imanin nga ata të cilët nuk marrin për gjykatës të Dërguarin, s.a.v.s dhe në të njëjtën kohë nuk janë të kënaqur me grykimin e tij. Gjithashtu, All-llahu, subhanehu ve tealë, i quajti pabesimtarë, mizorë dhe fasikë ata udhëheqës të cilët nuk gjykojnë me atë që shpalli Ai (Kur’anin), e thotë:

“...ata të cilët nuk gjykojnë me atë që e zbriti All-llahu ata janë pabesimtarët”(Maide: 44)

“...ata të cilët nuk gjykojnë me atë që zbriti All-llahu, ata janë vet mizorët”.(El-Maide : 45)

“...ata të cilët nuk gjykojnë me atë që zbriti All-llahu, ata janë vet fasikët”.(El-Maide : 47)

Pra, patjetër duhet gjykuar me atë që e zbriti All-llahu, subhanehu ve tealë, dhe duhet kërkuar grykimin nga Ai në të gjitha pikat e mospajtimeve në fjalët përpjekëse (ixhtihadije) mes dijetarëve. Fjalët e asnjë dijetari nuk duhet pranuar, përveç nëse ato i argumenton me Librin e All-llahut, subhanehu ve tealë, dhe Sunnetin e Muhammedit, s.a.v.s, pa kurrfarë fanatizmi për një medh’heb apo pa kurrfarë animi nga një imam. Me librin e All-llahut, subhanehu ve tealë, duhet gjykuar në të gjitha problemet njerëzore, e jo vetëm në gjendjet personale, sikurse ndodh me disa vende të cilat i përkasin islamit, sepse Islami është i përgjithshëm dhe nuk ndahet. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“O ju që besuat? Hyni në paqe (Islam) në tërësi” (El-Bekare: 16) Dhe thotë:

“...a në një pjesë të Librit (Kur’anit) besoni kurse një pjesë tjetër e mohoni?” (El-Bekare: 85)

Ky është obligim edhe për pasuesit e medh’hebeve, ata duhet t’i kthejnë fjalët e imamëve të tyre te Kur’ani dhe suneti e çka bie në pajtim me ta t’i përmbahen atyre fjalëve, kurse ato fjalë që bien në kundërshtim me to, të mos i përmbahen atyre me fanatizëm apo tendencë. Posaçërisht një gjë të tillë duhet ta bëjnë në çështjet e akides (besimit), sepse të gjithë imamët (All-llahu, i mëshiroftë) porositën një gjë të tillë (ky është medh’hebi i të gjithëve). Pra, ai që kundërshton këtë, nuk është pasues i tyre, edhe nëse u përket atyre. Këta bëjnë pjesë në mesin e atyre për të cilët All-llahu subhanehu ve tealë, thotë :

“Ata i konsideruan ‘ahbarët (piftërit çifutë) e tyre dhe ‘ruhbanët’ (murgjit e krishterë) e tyre e edhe Mesihun (Isain) të birin e Merjemes, për zotë pos All-llahut...” (Et-Tevbe: 31).

Ajeti nuk është i veçantë vetëm për çifutët dhe të krishterët, por për të gjithë ata që veprojnë si ata. Ai që kundërshton atë që urdhëroi All-llahu, subhanehu ve tealë dhe i Dërguari i Tij d.m.th. që nuk gjykon me ligjet e All-llahut, subhanehu ve tealë, ose kërkon një gjë të tillë sipas dëshirës së tij, ai ka hequr litarin e Islamit dhe imanin nga qafa e tij edhe nëse mendon se ai është besimtar. Sepse All-llahu subhanehu ve tealë, e mohoi atë që supozon një gjë të tillë dhe i përgënjeshtroi në supozimin e tyre. Fjala “jez’umun (supozojnë)” përdoret në gj.arabe për ata që pretendojnë një gjë të rrejshme si shkak i veprimit të kundërt nga ana e tyre. Këtë e vërtetoi thënia e Tij:

“...e ata u urdhëruan që ta mohojnë atë (tagutin)...”, sepse mohimi i tagutit është shtyllë e tevhidit sikurse thotë All-llahu, subhanehu ve tealë, në suren El Bekare: 256: *“...ai që mohon tagutin dhe beson në All-llahun, ai është kapur për litarin më të fortë...”*

Nëse kjo shtyllë nuk gjendet të besimtari ai nuk është monoteist. Monoteizmi (tevhidi) është baza e imanit, që me të vlejnë të gjitha veprat dhe pa të nuk vlen asnjë nga ato, sikurse u përmend në ajetin e mësipërm. Të gjykos sipas Tagutit, është besim në të. Mohimi i imanit

nga ata të cilët nuk gjykojnë me atë që zbriti All-llahu, subhanehu ve teala, argumentohet me atë se gjykimi me ligjin e All-llahut, subhanehu ve teala, është iman, akide (besim) dhe adhurim në të cilin duhet llogaritur muslimani. Ligji i All-llahut, subhanehu ve teala nuk duhet praktikuar vetëm pse ai është më i dobishëm te njerëzit dhe më i rregullt për siguri, sikurse mendojnë disa njerëz të cilët mbështetën vetëm në këtë aspekt, kurse harrojnë aspektin e parë. All-llahu subhanehu ve teala, i sulmon ata të cilët praktikojnë ligjet e Tij për shkak të ndonjë interesi, duke mos e konsideruar atë adhurim ndaj All-llahut, subhanehu ve teala. Ai thotë:

“Kur ata thirren që All-llahu dhe i dërguari i Tij të gjykojnë mes tyre, një grup nga ata e hedhin poshtë këtë. E nëse me ta është hakku- e drejta vijnë tek ai (Muhammedi) me bindje dhe respekt”. (En-Nur: 48-49) Pra atyre nuk u intereson diç tjetër përveç dëshirës së tyre, kurse ajo që kundërshton dëshirën e tyre nuk e pranojnë, sepse ata gjykimin tek i Dërguari, s.a.v.s. nuk e llogarisin adhurim (ndaj Allahut).

Dispozita për atë që nuk gjykon me ligjin e All-llahut, subhanehu ve teala

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“...ata që nuk gjykojnë me atë që zbriti All-llahu, ata janë vet pabesimtarët” (El-Maide:44)

Nga ky ajet kuptohet se mos gjykimi me atë që zbriti All-llahu, subhanehu ve teala, është kufr. Ky kufr ndonjëherë është kufr i madh që të largon nga mileti Islam, e ndonjëherë është kufr i vogël që nuk të largon nga mileti islam. Kjo varet nga besimi i udhëheqësit, nëse ai beson se ligjet dhe sistemet e tjera janë më të mira se sa ligjet islame dhe se ai nuk vlen për këtë kohë apo duke mos gjykuar me ligjin e All-llahut, subhanehu ve teala, dëshiron kënaqjen e pabesimtarëve dhe munafikëve, me këtë rast kufri i tij është i madh. Nëse ai beson së është obligim gjykimi më atë që e zbriti All-llahu, subhanehu ve teala, por ai largohet nga ai gjykim duke pranuar se ai meriton dënimin për këtë vepër të tij, me këtë rast ai është mëkatar dhe quhet kafir me kufr të vogël. Nëse ai nuk e njohu ligjin e All-llahut, subhanehu ve teala, pas përpjekjes së tij në njohjen e ligjit të tij dhe gaboi, ai është gabimtar dhe ka një sevap për përpjekjen e tij, kurse gabimi i tij falet. Kështu është kur gjykohet në një çështje të veçantë. Kurse gjykimi në çështjet e përgjithshme ndryshon. Dijetari i famshëm Ibnu Tejmije thotë: “Nëse udhëheqësi është fetar, por ai gjykon pa dituri është nga banoret e xhehenemit, e nëse është dijetar, por gjykon në kundërshtim me hakun që ai e di, është nga banoret e xhehenemit. E nëse gjykon pa drejtësi e pa dituri, edhe më tepër i takon të jetë nga banorët e xhehenemit. Kështu është nëse gjykon në një çështje personale. Kurse nëse gjykimi është i përgjithshëm në fenë e muslimanëve dhe ai hakun e bën të kotë, kurse të kotën e bënë hakk, sunnetin e bën risi e risinë e bën sunnet, të mirën e bën të keqe e të keqen e bën të mirë, largon nga ajo që urdhëroi All-llahu, subhanehu ve teala, dhe i Dërguari i Tij dhe urdhëron në atë që ndaloi All-llahu, subhanehu ve teala, dhe i Dërguari i Tij, në këtë rast problemi është tjetër, për të gjykon Zoti i botëve, Zoti i të dërguarve, Mbreti i Ditës së Gjykimit të cilit i takon falënderimi në këtë botë dhe në botën tjetër:

“I Tij është gjykimi tek Ai do të ktheheni” (El-Kasas: 88), dhe thotë:

“Ai është që e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzim (Kur’an) dhe fenë e vërtetë që të mbizotërojë mbi të gjitha fetë. Mjafton që All-llahu është dëshmitar.” (El-Fet’h: 28).

Gjithashtu, Ai thotë:

“...ata që nuk gjykojnë me atë që zbriti All-llahu, ata janë vet pabesimtarët” (El-Maide: 44).

Ai që lejon të gjykoj mes njerëzve me atë që ai e sheh drejtësi duke mos e ndjekur atë që e zbriti All-llahu, subhanehu ve teala, ai është kafir. Nuk ka asnjë popull që nuk urdhëron të gjykohet me drejtësi. Drejtësi në njërën nga ato ummete (popuj), mund të jetë ajo që shohin të mëdhenjtë e tyre. Shumë të tillë që i përkasin Islamit gjykojnë me traditat e tyre të cilat nuk i zbriti All-llahu, subhanehu ve teala, sikurse janë traditat e të parëve. Udhëheqësit e shihnin se kjo është ajo me të cilën duhet gjykuar e jo me Librin e Allahut, subhanehu ve teala, dhe Sunnetin e Muhammedit, s.a.v.s, e ky është, pra, kufri. Shumë njerëz kanë hyrë në Islam, por ata nuk gjykojnë përveç se me traditat ekzistuese me të cilat urdhërojnë udhëheqësit. Këta janë pabesimtarë kur e dinë se nuk lejohet gjykimi përveç se me atë që zbriti All-llahu, subhanehu ve teala, dhe nuk i përmbahen atij, por lejojnë që të gjykojnë në kundërshtim me atë që zbriti All-llahu, subhanehu ve teala. Pra ata janë kuffar (pabesimtarë).

Dijetari Muhammed Ibnu Ibrahim tha: kufrit të cilit i thuhet “kufr dune kufr” mosbesimi nën mosbesim (mosbesimi i vogël) është kur kërkohet gjykimi nga dikush tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve teala, duke besuar se ai është mëkatar dhe se gjykimi i All-llahut subhanehu ve teala, është hakk dhe kjo nga ai ndodh një apo dy herë. Kurse ai që i ka vendosur ligjet me rend dhe kërkon nënshtrimin ndaj tyre, ka bërë kufr, që e largon nga mileti islam, edhe nëse ai thotë se ka gabuar dhe ligjet e All-llahut, subhanehu ve teala, janë me të drejta. Pra ky dijetar (All-llahu, subhanehu ve teala, e mëshiroftë) bëri dallimin në mes gjykimit të pjesërishtëm, që nuk përsëritet, dhe mes gjykimit të përgjithshëm, i cili është bazë në të gjitha dispozitat apo në shumicën e tyre, Ai përforcoi se një gjë e tillë të largon nga mileti islam në përgjithësi, sepse ai që largon sheriatin islam dhe vendosë ligjet e sistemet njerëzore, ai e konsideron se ato sisteme janë më të vlefshme e më të dobishme se sa sheriatin islam. Nuk ka dyshim se një besim i tillë është kufr i madh që të largon nga mileti islam dhe kundërshton tevhidin.

Pretendimi i të drejtës për vënien e ligjeve dhe të lejimit (hallallit) e ndalimit (haramit)

Vënia e dispozitave sipas të cilave do të veprojnë njerëzit në adhurimet, bashkëpunimet dhe punët e tjera të tyre, si dhe vënia e dispozitave të cilat ndajnë konfliktet dhe i japin fund armiqësisë, janë e drejtë e All-llahut, subhanehu ve teala, Zotit të njerëzve dhe Krijuesit të krijesave:

“Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi (vënia e urdhrave), i madhëruar është All-llahu, Zoti i botëve” (El-Araf: 54). Ai e di se çfarë u bën dobi robëve të Tij kur Ai u cakton atyre ligje. Në emër të rububijetit të Tij (që vetëm Ai është Krijues e Furnizues) u cakton atyre ligje, kurse në emër të uluhijetit e ubudijetit të Tij (që vetëm Ai meriton të adhurohet e respektohet) i pranojmë dispozitat e Tij dhe dobia e praktikimit të tyre u rikthehet atyre. All-

llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“...nëse bini në konflikt rreth ndonjë çështjeje, kthene atë tek All-llahu dhe i Dërguari nëse besoni në All-llahun dhe Ditën e Gjykimit. Kjo është më hajr dhe kthim më i mirë”. (En-Nisa: 59), dhe thotë: *“E kur bini në konflikt rreth ndonjë çështjeje, gjykimi i saj është tek All-llahu”* (Esh-Shura: 10). All-llahu subhanehu ve teala, e urrejti që robët e Tij të marrin ligjvënës tjetër përveç Tij, e tha:

“...a mos ata kanë shokë (zotra) që u përcaktojnë atyre ligje në fe atë që All-llahu nuk ka lejuar...” (Esh-Shura: 21).

Ai që pranon ndonjë ligj tjetër përveç ligjit të All-llahut, subhanehu ve teala, ai ka bërë shirk në All-llahun, subhanehu ve teala. Ato ligje nuk i caktoi All-llahu, subhanehu ve teala dhe i Dërguari i Tij në ibadete janë risi (bidat), e çdo risi është shmangie (nga rruga e drejtë). Muhammedi s.a.v.s. tha: *“Ai që shpik në këtë çështjen tonë (fenë) diçka që nuk është prej saj, ajo nuk pranohet”*, në një transmetim tjetër thotë: *“Kush bën një punë që nuk është në pajtim me çështjen tonë (fenë tonë) ajo nuk pranohet”*. Atë që nuk e bëri ligj All-llahu subhanehu ve teala, e as i Dërguari i Tij për njerëzit në marrëdhëniet mes tyre dhe në pushtet, është gjykim i tagutit (i djallit) dhe i xhahilijetit:

“...a mosgjykimin e xhahilijetit e duan ata, a mos dikush është më i mirë se All-llahu në gjykim për popullin që beson” (El-Maide: 50). Gjithashtu, lejimi dhe ndalimi janë e drejtë e All-llahut, subhanehu ve teala, dhe askush nuk duhet të marrë guxim ta shoqërojë në këtë. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Mos i hani ato (të therurat që nuk u është përmendur emri i All-llahut, kjo (ngrënia e tyre), vërtetë është mëkat. Shejtanët i nxisin miqtë e vet që t’iu polemizojnë juve, e nëse i dëgjoni ata, atëherë jeni si ata politeistë” (El-En’am: 121).

All-llahu, subhanehu ve teala, e bëri shirk bindjen ndaj Shejtanit dhe ndaj dashamirësve të tij si shkak i lejimit të asaj që e ndaloi Ai. Gjithashtu, ata të cilët i binden dijetarëve dhe udhëheqësve në ndalimin e asaj që e lejoi All-llahu, subhanehu ve teala dhe në lejimin e asaj që ndaloi All-llahu, subhanehu ve teala, i kanë marrë ata për zotra përveç All-llahut, subhanehu ve teala, sepse Ai thotë:

“Ata i konsideruan “ahbarët” (priftërit çifut) e tyre dhe “ruhbanët” (murgjit të krishterë) e tyre dhe Mesihun (Isain) të birin e Merjemes, për zota pos All-llahut. Ata nuk urdhëruan ndryshe përveç se të adhurojnë një Zot të Vetmin, nuk ka të adhuroar tjetër përveç Tij, i lartë është Ai nga ajo që ata i shoqëruan (i bëjnë shirk)” (Et-Teube: 31). Transmeton Tirmidhiu dhe të tjerët (transmetuesit e haditheve) se Muhammedi, s.a.v.s. ia tha këtë ajet Adij Ibnu Hatim Et-Taiut, r.a. i cili i tha: *“O i Dërguari i All-llahut! Ne ata nuk i adhurojmë. Ai i tha: ‘A nuk ju lejojnë atë çka All-llahu e ndaloi dhe ju e lejoni atë dhe ju ndalojnë atë që All-llahu e lejoi dhe ju e ndaloni’.* Tha ai: Po si jo. Atëherë, i tha Muhammedi, s.a.v.s: *Ky është adhurimi ndaj tyre”.* Pra, bindja tyre ndaj ndalimeve dhe lejimeve që i bënë ata është adhurim ndaj tyre dhe shirk, bile ky është shirk i madh i cili kundërshton tevhidin, prej të cilit është dëshmia La ilahe il-lallah – nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve teala, sepse prej kësaj dëshmie është se lejimi dhe ndalimi janë e drejtë vetëm e All-llahut, subhanehu ve teala. Nëse gjendja është kështu me ata që u binden dijetarëve dhe adhuresve në lejimin dhe

ndalimin e tyre të cilët bijnë në kundërshtim me ligjin e All-llahut subhanehu ve teala, duke menduar se këta janë më afër diturisë e fesë dhe gabimi i tyre mund të ndodhë nga përpjekja e tyre, me ç'rast nuk kanë qëlluar hakkun për të cilën gjë shpërblehen, atëherë, si është gjendja me ata të cilët binden ndaj dispozitave të sistemeve konvencionale, të cilat janë themeluar nga pabesimtarët dhe ateistët, të cilat barten në vendet islame dhe me to gjykohen. **Ve la havle ve la kuvete il-la bilah.**

Gjykimi rreth përkatësisë në drejtimet ateiste dhe partitë injorante (xhahilijite)

1) Përkatësia në drejtimet ateiste, sikurse janë komunizmi, laicizmi, kapitalizmi dhe drrejtimit e tjera të kufrit, është dalje (ridde) nga feja Islame. Nëse ndonjëri që i përket atyre drejtimeve pretendon Islamin (i thotë vetes së është musliman), një gjë e tillë është nifaku më i madh sepse munafikët i përkasin Islamit në formën e jashtme, kurse në brendësin e tyre (në zemrat e tyre) janë me pabesimtarët, sikurse thotë All-llahu, subhanehu ve teala, për ta:

“Kur ata (munafikët) veçohen me dajtë (parinë) e vetë u thonë: “Ne jemi me ju, ne vetëm përqeshemi (me muslimanët)”. (El-Bekare: 14), dhe thotë: “Ata (munafikët) janë që presin se ç’po ju ngjanë juve. Nëse me ndihmën e All-llahut ngadhënjeni, ata thonë: “A nuk ishim me ju?” E nëse pabesimtarëve u takon ndonjë fitim, ata thonë: “A nuk mbizotëruam ne mbi ju (por nuk deshëm t’iu mposhtim) dhe penguan prej jush besimtarët”. (En-Nisa: 141).

Ata munafikë kanë nga dy fytyra: Me një fytyrë dalin para besimtarëve dhe me një fytyrë tjetër kthehen tek vëllezërit e tyre ateistë. Gjithashtu, ata kanë dy gjuhë, njërën nga ato në pamje të jashtme ua pranojnë muslimanët, kurse tjetra zbulon atë që mbajnë të fshehtë:

“Kur ata (munafikët) i takojnë ata që besuan u thonë: ‘Ne besojmë’, e kur të shkojnë tek shejtanët e tyre (pabesimtarët) u thonë: ‘Ne jemi me ju, ne vetëm përqeshemi (muslimanët)’. (El-Bekare: 14).

Ata refuzuan Kur’anin dhe rrugën e Muhammedit, s.a.v.s, duke i përqeshur dhe duke urrejtur pjesëtarët e tij. Gjithashtu refuzuan t’i nënshtrohen gjykimit të shpalljes duke u gëzuar me diturin e tyre që kanë dhe shtimi i saj, nuk u shton atyre përveç së sherr dhe mendjemadhësi. Andaj, ata gjithmonë i gjen duke u përqeshur me shpalljen e All-llahut, subhanehu ve tala, por në realitet:

“All-llahu përqeshet më ta duke i lënë të bredhin edhe më shumë në mosbesimin e tyre”. (El-Bekare: 15). All-llahu subhane hu ve teala urdhërojë që t’i përkasim besimtarëve të singertë. :

“O ju që besuat! Kini frikën All-llahut dhe bëhuni nga të singertit”. (Et-Teube: 119)

Këto drejtime ateiste janë armiqësore, sepse ato janë themeluar mbi të kotën. Komunizmi refuzon ekzistencën e Krijuesit të lartësuar dhe i lufton fetë qiellore. Pra, kush është ai që dëshiron të jetojë pa besim dhe të refuzoi realitetin e kështu ta shpërdori mendjen e tij. Laicizmi hedh poshtë fetë e posaçërisht fenë si sistem të jetës dhe mbështetet në materie e cila as nuk udhëzon e as nuk është qëllim në këtë jetë përveç jetës shtazore.

Kapitalizmi problem kryesorë e ka të mbledhë pasuri në çfarëdo mënyre duke mos shikuar a është hallall apo haram, sikurse nuk ka kurrfarë mëshire e butësie ndaj të varfërve. Ekonomia e tij mbështetet në kamatë e cila është luftë kundër All-llahut, subhanehu ve teala, dhe të Dërguarit të Tij, shkatërrim i shteteve, i njerëzimit dhe thithja e gjakut nga popujt e varfër! Cili njeri i mençur, duke mos përjashtuar atë që në zemrën e tij nuk ka besim fare, është i kënaqur të jetojë nën këtë sundim të paarsyeshëm ku mungon feja dhe çdo synim për jetën?! Sulmet e tyre ndaj vendeve islame janë rrjedhim i gjendjes së tyre (të vendeve islame) jashtë çdo udhëzimi e kriteri që përcaktohet nga feja e drejtë.

2) Përkatësia në partitë laike (xhahilijite) dhe ato me tendenca raciste është dalje nga feja Islame, sepse Islami hedhë poshtë fanatizmin dhe thirrjet laike (xhahilijite). All-llahu subhanehu ve teala, thotë:

“O ju njerëz! Ne ju krijuam prej një mashkulli e një femre dhe ju bëmë popuj e fise që të njiheni (të bashkëpunoni). Vërtetë, më fisniku në mesin tuaj është ai që është më i devotshmi (ai që më së shumti i frikësohet All-llahut)”. (El-Huxhurat: 13). Muhammedit, s.a.v.s, tha: “Nuk është prej nesh (muslimanëve) ai që fton në fanatizëm, nuk është prej nesh ai që lufton në emër të fanatizmit dhe nuk është prej nesh ai që hidhërohet në emër të fanatizmit” dhe tha: “Vërtet All-llahu ua largoi juve fanatizmin e kohës së injorancës dhe lavdërimin e me paraardhësit dhe tani nuk ekziston tjetër përveç besimtarë i devotshëm ose i prishur (pabesimtarë) pa fat. Njerëzit janë bij të Ademit, kurse Ademi u krijua nga dheu dhe nuk ka përparësi arabi ndaj jo arabit përveç me devotshmëri”.

Këto parti përçajnë muslimanët, kurse All-llahu subhanehu ve teala, urdhëroi bashkimin dhe bashkëpunimin në të mirë dhe devotshmëri dhe Ai ndaloi përçarjen dhe kundërshtimet. Ai thotë: *“...kapuni për Litarin e All-llahut (Kur'anin) të gjithë ju (muslimanë) dhe mos u përçani. Përkujtoni begatitë e All-llahut ndaj jush, kur ju ishit të armiqësuar e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ju me begatinë e Tij u bëtë vëllezër...”* (Ali Imram: 103). All-llahu, subhanehu ve teala, dëshiron prej nesh që të jemi një parti, të jemi Partia e All-llahut, subhanehu ve teala, partia e shpëtimit.

Por, fatkeqësisht Bota Islame iu nënshtrua këtyre fanatizmave gjakatare dhe nacionalizmave kombëtare nën presionet politike e kulturore nga Evropa dhe njerëzit filluan të besojnë se një gjë e tillë është diçka shkencore, e vërtet e vendosur dhe realitet nga i cili nuk mund të ikësh. Popujt islamë filluan të anojnë kah Perëndimi, kështu që e ringjallën atë fanatizëm të cilin Islami e zhduk, dhe e lavdërojnë atë duke shkruar poezi e duke ringjallur kohën paraislame të cilën Islami e quajti “Koha Xhahilijite (Koha e Injorancës)”. All-llahu subhanehu ve teala i begatoj muslimanët me daljen e tyre nga ajo kohë dhe i nxiti ata që ta falënderojnë për këtë begati. Është gjë e natyrshme që besimtari të mos e përkujtojë atë kohë ndryshe veçse me urrejtje dhe përbuzje. A mos i burgosuri i persekutuar kur lirohet nga burgu përkujton diç tjetër përveç dhimbjeve dhe rrëqethjeve të tij?

Dhe a mos i shëruari nga një sëmundje e rënd dhe e gjatë e cila e dërgojë buzë vdekjes kujton diç tjetër përveç nxjerrjes dhe ndryshimit të ngjyrës së tij?! Pra , obligim është ta dijë besimtari se këto parti janë dënim, të cilat All-llahu, subhanehu ve teala, i dërgojë për ata që refuzuan ligjin dhe urrejtën fenë e Tij. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Thuaj (Muhammed): ‘Ai (All-llahu) është i fuqishëm që t’iu dërgojë dënimin mbi kokat tua nga qielli ose nën këmbët tuaj (nga nën toka) apo t’iu ndaj në grupe e ta luftoni njëri tjetrin” (El-En’am: 65). Muhammedi s.a.v.s. thotë: “Kurdo që udhëheqësit e tyre (muslimanëve) nuk gjykojnë me Librin e All-llahut, Ai do të ngjallë armiqësi të madhe mes tyre”. Pra fanatizmi ndaj partive shkakton refuzimin e të drejtës që e zotërojnë të tjerët, sikurse është rasti me Çifutët për të cilët All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Kur atyre (çifutëve) u thuhet: ‘Besoni në atë që zbriti All-llahu (në Kur’an)’, ata thonë: ‘Ne besojmë në atë që na zbriti neve, kurse e mohojmë atë që është pas tij (pas Tevratit, e që është Kur’ani), edhe pse ai (Kur’ani) është vërtetues i atij që është me ata (Tevrati)...’ (El-Bekare: 91). Kështu ishte rasti edhe me njerëzit e kohës së xhahilijetit, të cilët refuzuan të drejtën me te cilën u dërgua Muhammedi, s.a.v.s, për shkak të ndjekjes me fanatizëm të gjendjes në të cilën ishin baballarët e tyre:

“Kur atyre (politeistëve të Mekës) u thuhet: ‘Pasoni atë që zbriti All-llahu’, ata thonë: ‘Jo, por ne pasojmë atë në të cilën i gjetëm baballarët tanë...’ (El-Bekare: 170).

Pasuesit e atyre partive kërkojnë që me ato parti të zëvendësojnë Islamin, të cilin All-llahu, subhanehu ve teala, ia dhuroi njerëzimit.

Koncepti materialist i jetës dhe dëmet e tij

Ekzistojnë dy koncepte për jetën, koncepti materialist për te dhe koncepti i vërtet jomaterialist. Secili koncept ka edhe efektet e tij:

Koncepti materialist i jetës (*kuptimi i tij*)

Sipas këtij koncepti, njeriu është i përqendruar në arritjen e kënaqësive të menjëhershme dhe puna e tij kufizohet brenda kësaj fushe, kështu që mendimi i tij nuk del përtej kësaj sfere dhe nuk punon dhe as nuk interesohet për diç tjetër. Ai (materialisti) nuk e din se All-llahu, subhanehu ve teala, e bëri këtë jetë arë mbjellëse (kopsht), frytet e të cilës merren në ahiret, ne boten e ardhshme. Këtë botë Ai e bëri vend të punës, kurse boten tjetër e bëri vend të shpërblimit. Ai që e shfrytëzon këtë botë duke bërë punë të mira, i fiton të dy botërat, e ai që humb këtë botë (duke qenë pabesimtar) ka humbur edhe ahiretin:

“...ai ka shkatërruar (ka humbur) dunjanë dhe ahiretin, e ky është shkatërrim i vërtet” (El-Haxh: 11). All-llahu, subhanehu ve teala, nuk e krijoi këtë botë kot, por e krijoj për një urtësi të madhe, dhe thotë:

“Ai është i cili krijoi vdekjen dhe jetën, që t’iu sprovtojë se cili nga ju është me vepërmiri”. (El-Mulk: 2) dhe thotë:

“Ne atë që është mbi tokë e bëmë zbukurim për te, që t’i sprovojmë ata (njerëzit) se cili nga ata do të jetë më vepërmiri” (El-Kehf: 7). All-llahu, subhanehu ve teala krijoi në këtë botë kënaqësi të përkohshme dhe bukuri të qarta, sikurse janë pasuritë, fëmijët, pozita, pushteti dhe kënaqësitë e tjera që vetëm Ai i di.

Disa njerëz (të cilët janë shumicë) e kufizuan shikimin e tyre në këto bukuri sipërfaqësore dhe kënaqën shpirtin e tyre me to, e nuk vështruan se çfarë fshihet pas tyre. Në

këtë mënyrë ata punuan për grumbullimin e pasurive dhe kënaqjen me to, duke lënë punën për atë që i pret ata më vonë. Ç'është edhe më keq, ata refuzuan të besojnë se ekziston jetë tjetër përveç kësaj jete. Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Ata (pabesimtarët) thonë: ‘Është vetëm kjo jeta jonë e dynjasë dhe ne më nuk ringjallemi’” (El-En’am: 29). All-llahu, subhanehu ve teala, ua tërhoqi vërejtjen njerëzve të cilët kanë koncept të tillë për jetën, e thotë:

“Vërtet, ata të cilët nuk shpresojnë në Takimin Tonë (Ditën e Gjykimit) janë të kënaqur me jetën e kësaj bote dhe janë të qetësuar, (kanë gjetur prehje) në të, dhe ata të cilët ndaj ajeteve (argumenteve) tona janë në gaflet (huti), këta janë për të cilët vend të tyre kemi përgatitur zjarrin, si shkak i asaj që ata punuan,” (Junus: 7-8) dhe thotë:

“Kush dëshiron jetën e dynjasë dhe zbukurimet e saj, ne do t’iu plotësojmë atyre shpërblimin e veprave të tyre në të, dhe atyre nuk do t’iu mungojë asgjë. Këta janë ata që në ahiret (boten tjetër) nuk kanë tjetër përveç zjarrit. Veprat që ata i punuan aty (në dynja) u dështuan dhe u asgjësuan këtu (ahiret)” (Hud: 15-16).

Ky qortim përfshinë ata që i përmbahen këtij koncepti, pa marrë parasysh a janë ata në mesin e atyre që punojnë punë të ahiretit me të cilat kanë për qëllim dobritë e kësaj jete, sikurse janë munafikët dhe ata që punojnë për sy e faqe, apo janë nga pabesimtarët të cilët nuk besojnë në ringjallje e as në llogari, sikurse është rasti me pasuesit e xhahilijetit dhe drejtimeve shkatërruese, sikurse janë kapitalizmi, komunizmi, laicizimi etj. Këta nuk njohin rëndësinë e jetës, kështu që koncepti i tyre nuk ndryshon nga koncepti i shtazëve, madje këta janë edhe më të humbur sepse mbyllën mendjet e tyre, e nënshtruan fuqinë e tyre dhe humbin kohen e tyre në diç që nuk u mbetet atyre e as nuk i mbetin asaj dhe nuk punuan për vendin ku do të kthehen, që është duke i pritur dhe i cili patjetër do të vijë. Derisa shtazët nuk kanë vendrikthim që i pret ato (edhe shtazët ringjallen, por pasi që të marrin hakkun e tyre shndërrohen në dhe) dhe nuk kanë mendje të mendojnë si ata, për këtë arsye All-llahu, subhanehu ve teala, për ta thotë:

“A mendon ti (Muhammed) se shumica e tyre dëgjojnë (kuptojnë), apo mendojnë. Ata nuk janë ndryshe veç se sikur shtazët, madje edhe në rrugë më të humbur” (El-Furkan: 44). All-llahu, subhanehu ve teala, përshkroi pasuesit e këtij koncepti se nuk kanë dituri:

“Por shumica e njerëzve nuk dinë. Ata dinë vetëm jetën sipërfaqësore të dynjasë, kurse për jetën e ahiretit janë në huti” (Err-Rrum: 6-7).

Pra edhe pse ata kanë praktikë dhe zell për zbulime dhe punë në industri prapë se prapë ata janë injorantë, nuk meritojnë t’u përshkruhet dituria, sepse dituria e tyre nuk ka kaluar horizontet e kësaj bote. Atëherë dituria e tyre është e mangët dhe poseduesit e saj nuk meritojnë që t’u jepet ai përshkrim fisnik e t’iu thuhet ulema, (dijetarë). Kjo gjë u thuhet vetëm atyre që njohin All-llahun, subhanehu ve teala, dhe ia kanë friken Atij, sikurse thotë All-llahu, subhanehu ve teala, .

“Vërtet, frikën e sinqertë ia kanë All-llahut ne mesin e robëve të Tij vetëm dijetarët” (Fatir: 28). Rrëfimi për ngjarjen e Karunit dhe të thesareve të tij, të cilat All-llahu, subhanehu ve teala, ia kishte dhënë, është koncept materialisht i jetës .

“Ai (Karuni) doli para popullit të tij me zbukurimet (pasurinë) e tij, e ata që donin jetën e dynjasë thanë: Ah sikur të kishim edhe ne ashtu si ka Karuni, ai vërtetë është me fat të madh” (El-Kasas: 79). Njerëzit shpresuan të kenë pasuri sikur ai dhe me që i patën lakminë, i thanë se ai është me fat të madh, duke u bazuar kështu në konceptin e tyre materialist. Kështu është gjendja edhe sot me shtetet pabesimtare dhe përparimin e tyre industrial e ekonomik. Ata që janë me besim të dobët në mesin e muslimanëve shikojnë ato shtete të habitur edhe nuk shikojnë gjendjen e tyre të kufrit dhe vendrikthimin e keq që i pret ata. Ky shikim i gabuar i tyre, i detyron ata t’i madhërojnë pabesimtarët, t’i respektojnë dhe t’i pasojnë në sjelljet dhe traditat e këqija të tyre, kurse në të njëjtën kohë këta musliman nuk i pasojnë ata në zellin, përgatitjen e fuqisë dhe zbulimet e zhvillimet e dobishme të tyre .

b) Koncepti i drejtë jomaterialist i kësaj jete .

Është koncepti , sipas të cilit pasurit , pushtetin dhe fuqinë materiale njeriu t’i përdor si mjet për punën e ahiretit. Bota në realitet nuk sulmohet në vetvete po lavdërimi dhe sulmi i drejtohen punës së njeriut në të. Ajo është peshojë dhe urë për në ahiret, prej saj mirret ushqimi për në xhenet. Jetën më të mirë të cilën banorët e xhenetit e gëzojnë, e arrijnë, në bazë të asaj që mbollën në këtë botë e cila është shtëpia e xhihadit, e namazit, agjërit, e shpenzimit në rrugën e All-llahut subhanehu ve teala, dhe përpjekjeve për të bërë mirë. All-llahu, subhanehu ve teala, u thotë banorëve të xhenetit:

“Hani dhe pini shijshëm (në Xhenet) për atë që parapritë në ditët e kaluara (të dynjasë)”. (El-Hakka: 24).

Err-rrukjetu vet-temaim-fryerja (shërimi) dhe hajmalitë (nuskat)

a) Fryrja ndahet në dy lloje:

Lloji i parë :

Është fryerja që është e pastër nga shirku si p.sh. t’i lexohet të sëmurit Kur’an ose të kërkohet mbrojtja e tij me emrat dhe sifetet (cilësitë) e All-llahut, subhanehu ve teala. Kjo mënyrë është e lejuar sepse Muhammedi s.a.v.s, ka fryrë, urdhëroj fryrjen dhe e lejoj atë . Transmeton Avf Ibnu Maliku , radiAll-llahu i cili thotë : “Ne frynim në kohën e injorancës kështu që e pyetëm të Dërguarin s.a.v.s të cilit i thamë : “O i dërguari i All-llahut si i sheh ti ato? Tha: “Mi paraqitni ju mua fryrjet (shërimit) tuaja (mënyrat e fryrjes). Nuk kanë gjë të keqe fryrjet nëse nuk mbajnë në vete shirk”. Dijetari i famshëm Sujutiu tha: “Dijetarët u pajtuan me lejimin e fryrjes me tri kushte:

- Që ajo të behet me Fjalë të All-llahut, subhanehu ve teala, me emrat dhe sifetet e Tij
- Të bëhet në gjuhën arabe dhe me ato fjalë që u dihet kuptimi .
- Të besohet se fryerja nuk ndikon vetvetiu, por me caktimin e All-llahut, subhanehu ve teala.

Metoda e saj është : *T’i lexohet apo ti fryhet (junfethu) të sëmurit ose i lexohet ujit të cilin e pinë i sëmuri sikurse përmendet në hadithin e Thabit Ibnul Kajsit, radiAll-llahu anhu : Se*

Muhammedi, s.a.v.s, mori dhe nga Bat'hani (vend i posaçëm) të cilin e vuri në një gotë pastaj i fryu atij me ujë dhe ia hodhi atij” .

Lloji i dytë :

Janë fryerjet që në vete kanë shirk. Ato janë fryerjet me anë të të cilave kërkohet ndihmë nga dikush përveç All-llahut, subhanehu ve teala, kërkohet ndihmë nga ata sikurse janë fryerjet me emrat e exhinëve, melaqeve, profetëve dhe njerëzve të mirë. Kjo është lutje ndaj dikujt tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve teala dhe është shirk i madh. Kështu është puna edhe me ato lutje që bëhen në gjuhë tjetër përveç gjuhës arabe ose me ato fjalë që nuk u dihet kuptimi, sepse frikësohet që ato të mbajnë në vete kufr apo shirk duke mos ditur një gjë të tillë. Ky lloji i fryrjes është i ndaluar (haram).

b) Hajmalitë (nuskat)

Janë ato që u varen në qaf fëmijëve që t'u largojnë syrin, e ndonjëherë ato i mbajnë edhe burrat edhe gratë. Ato ndahen në dy lloje:

Lloji i parë :

Janë hajmalitë nga Kur'ani, d.m.th në një letër shkruhen ajete të Kur'anit apo emra edhe sifate (cilësi) të All-llahut, subhanehu ve teala, të cilën e mban i sëmuri me vete me qëllim që të shërohet. Për këtë lloj të hajmalive dijetaret u ndanë në dy mendime:

Mendimi i parë: lejimi i tyre , këtë mendim e kanë Abdullah Ibn Amer Ibnul-As, një transmetim i Ajshes, Ebu Xhafer El Bakiri dhe Ahmed Ibn Hanbeli, radijallahu anhum, në një transmetim të tij, kurse në një transmetim tjetër e ndaloi atë, por disa thanë se me këtë ndalim kishte për qëllim hajmalitë që kanë në vete shirk.

Mendimi i dytë: ndalimi i tyre këtë mendim e kanë Abdullah Ibnu Mesudi, Ibn Abbasi, Hudhejfeja, Ukbetu Ubnu Amiri, Ibnu Akimi, radijallah anhum. Këtë mendim e ndoqën edhe disa tabi'in (pasardhës të sahabeve), sikurse janë nxënësit e Abdullah Ibnu Mesudit dhe Imam Ahmedit. Në një transmetim tjetër thuhet se shumë pasues të imanit Ahmedit e ndoqën këtë mendim, kurse nxënësit e tij të mëvonshëm të gjithë janë të pajtimit në ndalimin e saj. Duke u bazuar në transmetimin e Abdullah Ibnu Mesudit, radijallahu anhu, i cili tha: “Dëgjova të Dërguarin e All-llahut, subhanehu ve teala, duke thënë se disa fryerje, hajmali dhe amulete janë shirk”.

Ky mendim është i saktë nga tri aspekte:

Aspekti i parë: Ndalimi i përgjithshëm dhe mosekzistimi i veçorizmit të përgjithësisë .

Aspekti i dytë: Mbyllja e rrugës (dheria), sepse ato shkaktojnë ngjitjen e hajmalive që nuk janë të lejuara .

Aspekti i tretë: Sepse kur shkruhet diç nga Kur'ani, bartësi i saj do të bijë me të në sprovim, sepse do ta mbaj me vete në vende të ndyta, sikurse është shkuarja në nevojtoje me të, etj

Lloji i dytë:

Hajmalitë që nuk janë nga Kur'ani sikurse janë: Nuskat, eshtrat, hajmalitë, penjtë, nallet, gozhdat, emrat e xhinëve dhe të shejtanëve dhe emrat apo thëniet e panjohura, të gjitha këto janë rreptësisht të ndaluara dhe janë (shirk), sepse janë mbështetje në dikë tjetër

përveç All-llahut subhanehu ve teala, dhe në emrat e sifatet e Tij. Në një hadith Muhammedi s.a.v.s tha: “Ai që var diç që i është mbështetur asaj” dmth, All-llahu subhanehu ve teala, do ta lë të mbështetur në atë që ka ngjitur. Ai që lidhet për Allahun, subhanehu ve teala, kërkon strehim tek Ai dhe çështjen e Tij ia dorëzon Atij, Ai do t’i mjaftojë atij për çdo gjë, çdo gjë e largët do t’i vijë afër dhe çdo gjë e vështirë do t’i bëhet e lehtë. Kurse ai që mbështetet në krijesat e Tij, në hajmalitë, barërat, varrezat etj. All-llahu, subhanehu ve teala, do t’ua lë në dorë atyre të cilat nuk u bëjnë kurrfarë dobie. Kështu, njeriu i tillë humb besimin e tij, shkëputë çdo lidhje me Zotin e tij dhe Ai e poshtëron atë.

Obligim është për muslimanin që ta ruaj besimin e tij nga ato gjëra që e prishin atë, kështu ai nuk përdor ato barëra që janë të ndaluara dhe nuk shkon tek falltorët e njerëzit e prishur që të shërohet, sepse ata do t’ia sëmurin zemrën dhe besimin e tij. Derisa ai që mbështetet në All-llahun, subhanehu ve teala, do t’i mjaftojë Ai atij Disa njerëz i mbajnë këto gjëra duke mos patur kurrfarë sëmundje ndijore, por ata vuajnë nga sëmundjet psikike (iluzionet), sikurse është frika nga syri dhe hasedi apo kur disa i vëjnë ato në makinat, shtazët, dyert e shtëpisë ose në dyqanet e tyre. E gjithë kjo ndodh si shkak i besimit (akides) së dobët dhe mosmbështetjes së tyre në All-llahun, subhanehu ve teala.

Dobësia në besimin është sëmundje e vërtet që duhet të shërohet me njohjen e Tevhidit dhe besimit të vërtetë.

Sqarimi i dispozitës rreth betimit në dikë tjetër dhe jo në All-llahun, subhanehu ve teala, ndërmjetësimi (et-tevessul) dhe kërkimi i ndihmës nga krijesat

a) Betimi në dikë tjetër e jo në All-llahun, subhanehu ve teala,

Betimi bëhet duke përmendur ndonjë të madhëruar në veçanti. Madhërimi i takon vetëm All-llahun, subhanehu ve teala, kështu që nuk lejohet betimi në dikë tjetër përveç Tij. Dijetarët u pajtuan se betimi nuk bëhet ndryshe përveç se me All-llahun, emrat dhe sifatet e Tij. Gjithashtu ata u pajtuan rreth ndalimit të betimit në dikë tjetër. Betimi në dikë tjetër e jo në All-llahun, subhanehu ve teala, është shirk sepse Ibni Omeri radijallahu anhu, transmetoj se Muhammedi, s.a.v.s, tha: “Ai që betohet në diç tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve teala, ai ka mohuar apo ka bërë shirk”. Ky është shirk i vogël përveç nëse ai në të cilin është betuar betuesi është i madhëruar tek ai në atë shkallë sa që e adhuron atë. Atëherë ai bëhet shirk i madh, sikurse është rasti sot me adhuresit e varrezave, të cilët më shumë i frikësohen atyre që i madhërojnë në varreza se sa vetë All-llahut, subhanehu ve teala. Ata i madhërojnë ato varreza deri në atë shkallë sa që nuk betohen ndryshe në to përveç se duke qenë të sinqertë, e ndonjëherë ata betohen rrejtshëm në All-llahun, subhanehu ve teala.

Betimi është madhërim i atij në të cilin betohesh. Për këtë arsye betimi i takon vetëm All-llahut, subhanehu ve teala. Gjatë betimit duhet pasur kujdes që mos të përsëritet tepër, sepse All-llahu subhanehu ve teala, thotë:

“Mos e respekto atë që betohet shumë dhe është i poshtër” (El-Kalem: 10), dhe thotë *“...ruani betimet tuaja...”* (El-Maide: 89) dmth. Mos u betoni përveç kur është nevoja dhe duke qenë të sigurtë dhe në mirësi, sepse betimi i shumë apo gënjeshtër në të argumentojnë mosrespektin e mjaftueshëm ndaj All-llahut, subhanehu ve tealë e cila gjë kundërshton tevhidin. Muhammedi, s.a.v.s. tha: Tre personave All-llahu, subhanehu ve tealë, nuk do t’u flasë (Ditën e Gjykimit) e as që do t’i pastrojë ata dhe për ta do të ketë dënim të dhimbshëm, *“në mesin e tyre përmendi”* dhe një person që e ka bërë All-llahun subhanehu ve tealë, pasuri të tij, nuk blen e as nuk shet përveç se duke u betuar në Të”. Ky qortim i ashpër argumenton se betimi i tepërt është i ndaluar me qëllim që të respektohet emri i All-llahut, subhanehu ve tealë, dhe të madhërohet Ai. Gjithashtu, Allahu subhanehu ve tealë, ndaloi betimin (dëshminë) e rrejshëm (el-jemin el-gamus) dhe duke i përshkruar munafikët tha se ata betohen rrejshëm duke ditur të vërteten.

Nga kjo mund të përfundojmë

1. Ndalimi i betimit përveç se në All-llahun, subhanehu ve tealë, sikurse janë p.sh. betimi në besnikërinë, në Qaben, në Muhammedin, s.a.v.s, betimet e tilla janë shirk.
2. Ndalimi i betimit (dëshmisë) të rrejshëm në All-llahun, s.a.v.s. me qëllim. Ky betim i rrejshëm me qëllim quhet *“El-Jemin el-gamus”*.
3. Ndalimi i betimit të tepërt në All-llahun, subhanehu ve tealë, edhe nëse je i sigurtë, nëse nuk ekziston nevoja për betim, sepse një gjë e tillë është mosnderim ndaj All-llahut, subhanehu ve tealë.
4. Lejimi i betimit në All-llahun, subhanehu ve tealë, duke qenë i sigurtë, kur ka nevojë.

b) Afrimi tek All-llahu, subhanehu ve tealë, me krijesat e Tij

Et-tevessul (Afrimi): Është orvatja që t’i afroresh dikujt dhe të arrish tek ai me ndërmjetësim. Et-tevessul-i është afërsia, All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“... kini frikë All-llahun dhe kërkon i afim tek Ai” (El-Maide: 35).

d.m.th. kërkon i afim tek Ai me bindjen ndaj Tij dhe me pasimin e kënaqësive të Tij.

Afrimi (Et-tevessul) ndahet në dy lloje:

Lloji i parë:

Afrimi i lejuar, i cili është disa lloje:

- 1) Afrimi tek All-llahu, subhanehu ve tealë, me emrat dhe sifetet e Tij, ashtu sikurse urdhëroj Ai:

“All-llahu ka emrat më të bukur, andaj thirreni ju Atë me ato dhe lini ata (pabesimtarët) që bëjnë shtrembërime me emrat e Tij, ata do të shpërblehen për atë që punojnë”. (El-Araf: 180).

- 2) Afrimi tek All-llahu, subhanehu ve tealë, me besimin dhe veprat e mira të cilat i ka bërë ai që kërkon ndërmjetësim, sikurse thotë All-llahu, subhanehu ve tealë, për ata që besuan:

“O Zoti ynë! Ne dëgjuam një thirrës duke thirrur në besim (e i cili thoshte): ‘Besoni në Zotin tuaj. E ne besuam. Zoti ynë! Na i fal mëkatet tona, na i mbulo mëkatet tona dhe na bë të vdesim me të mirët’. (Ali Imran: 193)

Dhe, sikurse thuhet në hadithin e atyre tre personave të cilët u mbyllën në një shpellë e nuk patën mundësi të dalin derisa nuk filluan të kërkojnë afrim te All-llahu, subhanehu ve teala, me veprat e mira të tyre. Kështu që All-llahu, subhanehu ve teala, ua hapi shpellën atyre dhe dolën nga ajo.

3) Afrimi tek All-llahu, subhanehu ve teala, me Tevhidin (Njëshmërinë) e Tij, sikurse ishte rasti me Junusin, alejhis-selam:

“Ai thirri, u lut në errësira (brenda në bark të peshkut dhe në errësirat e detit e të natës) : ‘Se nuk ka Zot tjetër përveç Teje, Ti je i pastër, pa të meta...’ (El-Enbija: 87)

4) Afrimi tek All-llahu, subhanehu ve teala, me paraqitjen e dobësisë, nevojës dhe varfërisë ndaj Tij, sikurse tha Ejubi, alejhis-selam:

“Mua, vërtet, me ka goditur dëmi, kurse Ti je mëshiruesi më i madh” (El-Enbija: 83).

5) Afrimi tek All-llahu, subhanehu ve teala, me lutjen e robërve të mirë e të devotshëm, sikurse bënë sahabet kur mbretëronte thatësia, ata kërkonin nga Muhammedi s.a.v.s, të lutet për ta, kurse pas vdekjes së tij, kërkonin një gjë të tillë nga xhaxhai i tij Abbasi radijallahu-anhu, i cili lutej për ta.

6) Afrimi tek All-llahu, subhanehu ve teala, duke pranuar gabimin, sikurse ishte rasti me Musain, alejhim-selam:

“Tha Musai: Zoti im! Unë i bëra mizori vetës, e Ti më fal mua...” (El-Kazas: 16).

Lloji i dytë

Afrimi jo ligjor (i ndaluar):

Ky është afrimi tek All-llahu, subhanehu ve teala, duke kërkuar lutje dhe ndërmjetësim nga të vdekurit, afrimi me pozitën e lartë të Muhammedit s.a.v.s, dhe ndërmjetësimi me qenësinë e krijesave ose hakun e tyre. Më poshtë do ta sqarojmë këtë:

1. Kërkimi i lutjes nga të vdekurit nuk lejohet:

I vdekuri nuk ka mundësi të bëj lutje sikurse kishte mundësi kur ishte në jetë. Kërkimi i ndërmjetësimit nga të vdekurit nuk lejohet, sepse Omer Ibnul-Hatabi, Muavijetu Ibnu Ebi Sufjani, sahabet e tjerë dhe tabi’inët (pasardhësit e sahabëve, radijallahuanhum), kur kishte thatësi kërkonin lutjen për shi dhe afrimin të All-llahu, subhanehu ve teala, me ata që ishin gjallë si Abbasi dhe Zejd ibnul Esvedi, e nuk kërkonin afrim, ndërmjetësim dhe lutje për shi nga Muhammedi, s.a.v.s, as te varri i tij e as te varri i dikujt tjetër. Ata anuan kah zëvendësimi i tij me Abbasin dhe Zeidin. Me një rast Omeri, radijallahu anhu, u lut:

“O Zoti ynë! Ne afroheshim te Ti me profetin tonë, e na e lëshojë shiun, kurse tani afrohem te Ti me xhaxhain e profetit tonë, të lutem na lëshojë shi”. Omeri radijallahu-anhu, e zëvendësojë Abassin me Muhammedin, s.a.v.s, me qëllim të nuk mund të afroheshin në mënyrë ligjore sikurse e bënë kur ai ishte në jetë.

Ata kishin mundësi që të vinë te varri i tij dhe të kërkojnë afrim me të All-llahu (dmth. Sikur të ishte e lejuar). Pra, mos veprimi i një gjëje të tillë nga ata, është argument se

afrimi me të vdekurit, pa marrë parasysh me lutjen apo ndërmjetësimin e tyre, është i ndaluar. Nëse kërkimi i lutjes dhe i ndërmjetësimit nga Muhammedi, s.a.v.s. të ishte ashtu sikur ishte ai në jetë, edhe kur kaloj në jetë tjetër, shokët e tij nuk do të kërkonin një gjë të tillë nga ata që janë nën të me pozitë.

2. Afrimi me pozitën (mekamin) e Muhammedit, s.a.v.s, apo të dikujt tjetër nuk është i lejuar:

Ata të cilët lejojnë këtë afrim, marrin për argument këtë hadith, “Kur ta lutni All-llahun, luteni me pozitën time, sepse pozita ime tek All-llahu është e madhe”. Ky hadith është i shpifur dhe nuk gjendet në asnjë libër autentik të dijetareve të hadithit, e as që gjendet në librat autentike të muslimanëve. E me që në këtë çështje nuk ka argumente të qarta, një gjë e tillë nuk lejohet, sepse adhurimet (ibadetet) nuk vërtetohen përveç se me argumente të qarta.

3) Afrimi me qenien e krijesave nuk lejohet:

Nëse lutja ndaj dikujt është betim, ai është betim kundër All-llahut, subhanehu ve teala. Nëse betimi me qenien e ndonjë krijese, bëhet kundër ndonjë krijese tjetër, është shirk dhe nuk lejohet, sikurse thuhet në hadith, e si mund të bëhet betimi me krijesën kundër krijesit të madhëruar. Kurse, nëse lutja më qenien e ndonjë krijese nuk është betim, por vetëm shkak, duke ditur se All-llahu, subhanehu ve teala, nuk e bëri lutjen me ndonjë krijesë shkak të përgjigjes dhe nuk ua bëri këtë ligj robërve të Tij.

4) Afrimi me hakun (të drejtën) e krijesave nuk lejohet për dy arsye:

Arsyeja e parë: hakku i askujt nuk është obligim për All-llahun, subhanehu ve teala, por Ai është i cili bën mirësi me një gjë të tillë ndaj krijesave të Tij, sikurse thotë:

“Për Ne është hakk që besimtarët t’i bëjmë triumfues” (Err-Rrum: 47). Pra, kur bindësi ndaj All-llahut, subhanehu ve teala, meriton shpërblimin, ajo është mirësi dhe begati nga Ai, e nuk është meritë të cilën e meriton një krijesë ndaj krijesës tjetër (apo një njeri ndaj tjetrit).

Arsyeja e dytë: Hakun të cilin All-llahu, subhanehu ve teala, ia dha ndonjë robi të Tij me mirësinë e Tij është hakk i veçantë për të dhe të tjerët nuk kanë dorë në të, e nëse me të kërkon afrim ai që nuk e meriton atë, me këtë rast ai kërkon afrim me një çështje të huaj që nuk ka kurrfarë lidhje me të, kështu që nuk i bënë kurrfarë dobie.

Kurse hadithi: “ Të lutem All-llah me hakkun e atyre që të luten (esseluke bihakkis-sailin)”, nuk është hadith i vërtetuar, sepse në senedin (zinxhirin) transmetues të tij gjendet Atijjetul-Afvi, i cili është transmetues i dobët sipas pajtimit të të gjithë muhadithinëve (njohësve të hadithit). E nëse hadithi është i tillë, nuk mund të merret argument për kesi çështje, me rendësi të akides (besimit). Pastaj në të nuk ka afrim me hakkun e ndonjë personi të veçantë, por vetëm me hakkun e atyre që luten në përgjithësi, kurse haku i atyre që luten është përgjigja nga All-llahu, subhanehu ve teala, sikurse u premtoj All-llahu, subhanehu ve teala, atyre një gjë të tillë. Ky është hakk për ta që All-llahu, subhanehu ve teala, ia bëri obligim Vetës, e nuk ia bëri atë Atij askush obligim. Atëherë, ky është afrim, tek Ai me premtimin e Tij të sigurtë e nuk është me hakkun e krijesave.

c) Dispozita (gjykimi) rreth kërkimit të ndihmës nga krijesat

Kërkimi i ndihmës nga krijesat ndahet në dy lloje:

Lloji i parë:

Kërkimi i ndihmës nga krijesat ne ato çështje që ata kanë mundësi, kjo është e lejuar.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“...dhe bashkëpunoni (ndihmohuni) në bamirësi dhe devotshmëri...” (El-Maide: 2) dhe thotë: *“...i kërkojë ndihmë (Musait alejhis-selam) ai (beni israiliti) që ishte nga pasuesit e tij kundër atij që ishte nga armiqtë e tij (nga Faraoni)...”* (El-Kasas: 15).

Lloji i dytë:

Kërkimi i ndihmës nga krijesat në ato çështje që nuk ka mundësi askush tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve teala, sikur është kërkimi i ndihmës nga të vdekurit, kërkimi i ndihmës nga të gjallët në ato punë që nuk ka mundësi tjetër kush përveç All-llahut, subhanehu ve teala, sikurse është shërimi i të sëmurëve, largimi i fatkeqësive dhe largimi i dëmit: **ky lloj është i ndaluar dhe është shirk i madh**. Në kohën e Muhammedit, s.a.v.s, një munafik e kishte shprehur t’i fryej besimtarit; disa nga shokët e Muhammedit, s.a.v.s, thanë: “ejani të kërkojmë ndihmë te Muhammedi s.a.v.s kundër këtij munafiku. Muhammedi , s.a.v.s, u tha: ‘Nuk kërkohet ndihma nga unë por ndihma kërkohet nga All-llahu, subhanehu ve teala’, ai e urrejti të përdoret kjo shprehje për të, edhe pse ai kishte një mundësi të tillë në jetën e tij. Por ai, s.a.v.s, dëshiroj te mbroj tevhidin, t’i mbyllë rrugët e shirkut, te përulet para Zotit të tij dhe t’i vë në kujdes ummetit të tij mjete e shirkut në fjalë e vepra. Nëse një gjë të tillë nuk e lejoi Muhammedi s.a.v.s, gjatë jetës së tij kur kishte mundësi, e si kërkohet ndihmë nga ai pas largimit nga kjo jetë, ne ato çështje që nuk ka mundësi askush tjetër përveç All-llahut, subhanehu ve teala?! Pastaj, nëse kjo nuk i lejohet Muhammedit, s.a.v.s, aq me pak do t’iu lejohet të tjerëve.

Sqarimi se çka obligohet rreth besimit në Muhammedin, s.a.v.s, në familjen dhe shokët e tij

1. Obligimi i dashurisë dhe respektit të tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem

Fillimisht, është obligim për çdo rob të shpreh dashuri ndaj All-llahut, subhanehu ve teala, gjë që është adhurimi më i madh. Ai thotë:

“...kurse ata të cilët besuan e duan All-llahun me së shumti” (El-Bekare: 165). Sepse Ai është Zoti, i Cili nga mirësia e Tij ua krijoj robërve të Tij të gjitha begatit. Pastaj, pas dashurisë së All-llahut, subhanehu ve teala, obligim është dashuria për të Dërguarin e Tij, Muhammedin, s.a.v.s, sepse ai ftoi në rrugën e All-llahut, subhanehu ve teala, komunikoj sheriatin dhe sqaroj dispozitat e Tij. Pra, mirësinë të cilën e arritën besimtarët në këtë botë dhe në botën e ardhme është nga dora e këtij të Dërguari dhe nuk hyn askush në Xhenet pa respektin dhe ndjekjen e Sunnetit të tij. Në një hadith Muhammedi, s.a.v.s. tha: “Tri gjëra nëse gjenden tek njeriu, ai ka shijuar ëmbëlsinë e imanit: Që All-llahu dhe i Dërguari i Tij të jenë më të dashurit tek ai, që dikë ta dojë vetëm për All-llahun dhe të urrej të rikthehet në kufër, sikurse ai që urren të hudhet në zjarr pasi që All-llahu e shpëtoi nga ai. Dashuria për Muhammedin s.a.v.s. vjen pas dashurisë për All-llahun subhanehu ve teala. Ekzistojnë shumë tekste në veçorinë rreth dashurisë për Muhammedin s.a.v.s. më tepër se çdo kush përveç All-llahut subhanehu ve teala, p.sh: “Asnjëri nga ju nuk ka besuar derisa unë të mos jem për të më i dashur se sa fëmiu, babai dhe njerëzit në përgjithësi”.

Madje për besimtarët Muhammedi, a.s. duhet të jetë më i dashur se sa vetja e tij, sikurse i tha Muhammedi s.a.v.s. Omerit, r.a. i cili i tha atij: “O i Dërguari i All-llahut! Ti je për mua më i dashur se çdo gjë përveç vetes time. Ai i tha: “betohem në Atë, që shpirti im është në dorën e Tij, ti nuk ke besuar derisa nuk jam për ty më i dashur edhe se sa vetja jote”, atëherë, Omeri r.a. i tha: “Ti tani je tek unë më i dashur se vetja ime. Ai i tha: ‘Tani e plotësove imanin-o Omer’. Nga kjo kuptohet se dashuria për Muhammedin, s.a.v.s është obligim dhe i paraprin çdo dashuri përveç dashurisë së All-llahut, subhanehu ve teala, të cilën e pason sepse dashuria e tij është në emër të All-llauht subhanehu ve teala, me shtimin e dashurisë ndaj All-llahut subhanehu ve teala shtohet edhe dashuria për të dhe me pakësimin e dashurisë për All-llahun, subhanehu ve teala, pakësohet edhe dashuria për të.

Dashuria e Muhammedit s.a.v.s. obligon respektimin e tij, ndjekjen e rrugës së tij, vënien e fjalës së tij në rend të parë, para fjalës së çdo njeriu dhe obligon ndjekjen e sunnetit të Tij.

Dijetari i famshëm Ibnul-Kajjimi tha: “çdo dashuri dhe respekt ndaj njerëzimit lejohet nëse vjen pas dashurisë së All-llahut, subhanehu ve teala, dhe madhërimit të Tij, siç është p.sh. dashuria për Muhammedin, s.a.v.s, dhe respekti i tij, të cilat janë plotësim i dashurisë për Dërguesin (All-llahun) e Tij dhe madhërimit të Tij. Ummeti i tij e duan atë për shkak të dashurisë së All-llahut, subhanehu ve teala, për të dhe e respektojnë atë si shkak i respektit të All-llahut, subhanehu ve teala, për të. Kjo dashuri, pra, është nga obligimet e dashurisë së All-llahut, subhanehu ve teala.”

Kjo ndodh për shkak se All-llahu, subhanehu ve teala, i dhuroj Muhammedit, s.a.v.s, dritë dhe dashuri prandaj nuk ka ekzistuar dikush që te ketë pasur respekt dhe nderim, për të sikurse kishin shokët e Muhammedit, s.a.v.s, për të. Amr Ibnul Asi pas që pranoi Islamin tha: se asnjë njeri me parë nuk kishte urrejtur me shumë se atë (Muhammedin, s.a.v.s), por kur ai pranoi Islamin, nuk kishte njeri mbi fytyrë të tokës që e donte dhe e respektonte më shumë se atë. Ai tha: “Sikur ju të më pyetni mua t’ua përshkruaj atë (Muhammedin, s.a.v.s) nuk do të kisha mundësi sepse unë nuk pata mundësi asnjëherë t’i mbush sytë e mijë nga drita e tij”.

Kurse Urvetu Ibnu’Mesudi u tha kurejshitëve: “O ju popull! Mua më dërguan tek Kisraja (mbreti i persianëve) dhe tek Kajseri (mbreti i romakëve), por nuk pash njeri te cilin e respektojnë shokët e tij sikurse e respektojnë shokët-Muhammedin.

2. Ndalimi i ekstremizmit (El-Gulevvu) dhe teprimit (El-Itra) ne lavdërimin e tij

El-Gulevvu (ekstremizmi): është kalimi i kufirit. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: “...mos e teproni ne fenë tuaj...” (En-Nisa: 171).

El-ittra (teprimi): është kalimi i kufirit ne lavdërim duke gënjyer. Me fjalën ekstremizëm ndaj Muhammedit, s.a.v.s, është për qellim kalimi i kufirit në çështjen e tij duke e ngritur atë ne shkallen e adhurimit dhe duke i dhënë atij disa veçanti hyjnore, si p.sh. t’i lutesh atij dhe të kërkosh ndihmë nga ai e jo nga All-llahu, subhanehu ve teala, dhe te betohesh ne te.

Kurse me fjalën teprim ndaj Muhammedit, s.a.v.s, është për qellim teprimi ne lavdërimin e tij te cilën gjë ai e ndaloi me fjalën e tij: “Mos me lavdëroni mua ashtu siç e lavdëruan të krishterët birin e Merjemes, Unë jam vetëm një rob i All-llahut, pra thuani: Rob i All-llahut dhe i Dërguari i Tij”, d.m.th. mos me lavdëroni me gjera te kota dhe mos e kaloni kufirin në lavdërimin tim, sikurse e kaluan kufirin të Krishterët ndaj Isait, alejhis-selam, kështu që ia mvëshën atij hyjninë, kurse mua me përshkruani ashtu siç me përshkoi Zoti im e thuani: Rob i All-llahut dhe i Dërguari i Tij. Kur disa shokë të tij i thanë atij: “Ti je zotëriu i ynë”. Ai u tha: “Zotëriu është All-llahu i madhëruar e i lartësuar”. E kur atij i thanë: “Më i vlefshmi nga ne dhe më i madhërishmi”. Ai tha: “Thuani fjalët tuaja ose diç nga fjalët tuaja dhe mos t’iu nxitë shejtani”.

Disa te tjerë i thanë atij: “O i Dërguari i All-llahut, o me i miri në mesin tonë dhe i biri i më të mirit tonë, o zotëriu i ynë dhe i biri i zotëriut tonë”! Ai u tha: “O ju njerëz! Thuani fjalët tuaja dhe mos t’iu hedh në epshe (mashttrim) Shejtani. Unë jam Muhammedi, robi i All-llahut dhe i Dërguari i tij, nuk kam dëshirë të më ngritni mbi pozitën në të cilën me ngriti All-llahu i Gjithëfuqishëm e i Madhëruar”.

Muhammedi, s.a.v.s, urrente që të lavdërohet me këto fjalë “ ti je zotëriu i ynë, ti je më i miri në mesin tonë, ti je me i vlefshmi, ti je më i madhëruari”, edhe pse ai është krijesa më e lavdëruar dhe më fisnike ne përgjithësi. Ai ua ndaloj fjalët e tilla duke i larguar nga ekstremizmi dhe teprimi ne hakun e tij dhe duke tentuar mbrojtjen e tevhidit. Ai i udhëzoi ata që ta përshkruajnë me dy cilësi, të cilat janë shkallet më të larta të një robi, dhe nuk janë kalim i kufirit e as rrezik ndaj akides (besimit), ato janë: Robi i All-llahut dhe i Dërguari i tij. Ai nuk dëshiroj që ta ngrisin mbi pozitën në të cilën All-llahu, subhanehu ve teala e ngriti dhe ia miratoj atij. Fatkeqësisht , shumica e njerëzve e kundërshtuan ndalimin e tij, kështu që ata

filluan t'i luten atij, të kërkojnë ndihmë nga ai, të betohen në të dhe të kërkojnë nga ai çka kërkohet vetëm nga All-llahu, subhanehu ve teala, sikurse veprohet nëpër mevlude, poezi, ilahi, etj. Ata nuk mund të bëjnë dallimin në mes të hakut të All-llahu, subhanehu ve teala, dhe të hakut të Muhammedit, s.a.v.s.

Dijetari i famshëm Ibnu-Kajjimi në poezinë e tij thotë:

Allahu ka të drejtë që dikujt tjetër nuk i takon,

Edhe rob i tij (Muhammedi) ka të drejtë, ato janë dy të drejta,

Mos i bëni ato dy hake një hak,

Pa i dalluar ato e pa i afruar.

3. Sqarimi i pozitës së tij, s.a.v.s.

Nuk ka asgjë në sqarimin dhe besimin e pozitës së tij duke e lavdëruar atë ashtu si e lavdëroj atë All-llahu, subhanehu ve teala, dhe në përmendjen e pozitës së tij në të cilën e veçoj All-llahu, subhanehu ve teala. Muhammedi s.a.v.s. ka pozitën më të lartë të cilën All-llahu, subhanehu ve teala, ia dhuroi, Ai është rob i All-llahut, subhanehu ve teala, i Dërguari i Tij dhe më i miri i krijesave të Tij. Ai është më i miri i të gjitha krijesave në përgjithësi. Ai është i Dërguari i All-llahut, subhanehu ve teala, te njerëzit në përgjithësi si edhe tek xhinët, ai është më i lavdëruari në mesin e profetëve, ai është vula e profetëve, nuk ka profet tjetër pas tij. All-llahu, subhanehu ve teala, ia zgjeroi gjoksin, i ngriti përmendjen, nënshtrimin dhe përluljen ua bëri cilësi atyre që kundërshtojnë urdhrin e tij dhe atij (Muhammedit) i takon Mekami Mahmudi (vendi i lavdëruar), për të cilin All-llahu, subhanehu ve teala, i thotë:

"...ndoshta Zoti yt do të ngritë ty (Muhammed) në një vend të lavdishëm" (El-Isra:79),

D.m.th. vendi në të cilin të ngritëm Ditën e Kijametit që të ndërmjetësosh për njerëzit, ky është vend i posaçëm vetëm për Muhammedin, s.a.v.s. në mesin e të gjithë profetëve.

Muhammedi s.a.v.s, është krijesa e All-llahut, subhanehu ve teala, që Atij i ka frikën më shumë se kujtdo edhe është më i devotshmi ndaj Tij. All-llahu, subhanehu ve teala, ndaloi ngritjen e zërit pranë tij dhe i lavdëroi ata të cilët ulin zërat e tyre në praninë e tij. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"O ju që keni besuar! Mos i ngritni zërat tuaj mbi zërin e të Dërguarit (Muhammedit) dhe mos e thirrni atë ashtu siç e thërrisni njëri-tjetrin, e kështu të zhdukën veprat tuaja duke mos e hetuar ju. Ata të cilët ulin zërat e tyre pranë të Dërguarit të All-llahut ata janë që All-llahu zemrat e tyre i ka përshtatur për devotshmëri, ata kanë falje mëkatesh dhe shpërblim të madh. Ata që të thërrasin përtej mureve, shumica e tyre janë nga ata që nuk kuptojnë. E sikur ata të bënin durim derisa të kishe dalë ti vetë, do të ishte më edukative për ta. All-llahu është Mëkatëfalës, Mëshirues" (El-Huxhurat: 2-5).

Dijetari i famshëm Ibni Kethiri, duke komentuar këto ajete në tefsirin e tij, thotë:

"Këto janë ajete më të cilat All-llahu, subhanehu ve teala, edukoj robërit e Tij besimtarë, se si ata të sillen ndaj Muhammedit, s.a.v.s, se si ta vlerësojnë, ta respektojnë, ta lavdërojnë dhe si ta madhërojnë. Mos t'i ngrisin zërat e tyre në prani të Muhammedit, s.a.v.s. mbi zërin e tij. Gjithashtu, ai ua ndaloi atyre që atë ta ftojnë me emrin e tij siç ftojnë ata njëri-tjetrin, e t'i thuhet: O Muhammed, por ai të ftohet me shpalljen e dërgesës, e ta thërrasin: O i Dërguar i All-llahut, o profet i All-llahut. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Thirrjen e të Dërguarit mos e bëni sikurse thirrjen tuaj ndaj njëri tjetrit” (En–Nur: 63). Vetë All-llahu, subhanehu ve teala, e thërret atë o profet, o i Dërguar dhe All-llahu, subhanehu ve teala, e melaqet e Tij, i bëjnë lutje atij, me të cilën gjë i urdhëroi edhe besimtarët. Ai thotë:

“Vërtetë, All-llahu dhe melaqet e tij e madhërojnë pejgamberin. O ju që keni besuar madhëroni atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni atë me selam” (El-Ahzab: 56).

Por, lavdërimi i tij nuk veçohet në ndonjë kohë apo mënyrë përveç se me argument të vërtet nga Kur’ani dhe Sunneti. Ata të cilët bëjnë mevlud për lavdërimin e tij, duke e veçuar ditën në të cilën mendojnë se ai lindi, është risi (bidat) e papëlqyeshme. Respekti ndaj Muhammedit, s.a.v.s, është edhe respekti ndaj Sunnetit të tij dhe besimi se veprimi më të është obligim dhe se ai ka pozitën e dytë pas Kur’anit në obligimin e respektit dhe veprimit me të. Sepse Sunneti i tij është shpallje nga All-llahu, subhanehu ve teala, sikurse thotë Ai:

“Ai (Muhammedi) nuk flet me hamendje. Por, ai (Kur’ani dhe fjalët e tij) është shpallje që i shpallet” (En-Nexhm: 3-4).

Pra, nuk lejohet dyshimi në të (Sunnetin), zvogëlimi i rëndësisë së tij ose te thuhet filan hadithi është sahih (i vertetë), filan hadithi është daif (i dobët) dhe nuk lejohet shpjegimi i tyre veçse me dituri dhe njohjen e lëndës së hadithit. Në këtë kohë janë shtuar injorantët të cilët flasin rreth Sunnetit të Muhammedit, s.a.v.s, posaçërisht disa të rinj të cilët ende janë në semestrat e para te shkollës. Ata i verifikojnë dhe i dobësojnë hadithet dhe i kritikojnë transmetuesit pa kurrfarë diturie, vetëm se kanë lexuar disa libra. Ky është rrezik i madh për ta dhe për ummetin. Ata duhet t’i kenë frikë All-llahut, subhanehu ve teala, dhe të ndalen në kufijtë e tyre .

Obligimi i bindjes ndaj Muhammedit, s.a.v.s, dhe pasimit të tij

Obligim është bindja ndaj Muhammedit, s.a.v.s, me kryerjen e urdhrave të tij dhe me largimin nga ndalesat e tij. Një gjë e tillë është nga obligimet e dëshmisë se ai është i dërguar i All-llahut, subhanehu ve teala. All-llahu, subhanehu ve teala, urdhëroi bindjen ndaj tij në disa ajete të Kur’anit, ndonjëherë duke e bashkuar me bindjen ndaj tij, si p.sh:

“O ju që keni besuar! Bindjuni All-llahut dhe bindjuni të Dërguarit (Muhammedit)”. (En-Nisa: 59), dhe ajete të ngjashme me këtë, e ndonjëherë të vetmuar si p.sh. *“Ai që i bindet të dërguarit i është bindur All-llahut”*. (En-Nisa: 80). Dhe :

“...bindjuni të Dërguarit, në mënyrë që të mëshiroheni” (En-Nur: 56). Kurse ndonjëherë iu kërcënohet atyre që kundërshtojnë të Dërguarin e Tij, sikurse është fjala e Tij: *“Le të ruhen ata të cilët e kundërshtojnë urdhrin e tij (Muhammedit) se ata do t’i zë ndonjë sprovim (fitne) ose do t’i godas një dënim i dhimbshëm”*. (En-Nur: 63), d.m.th. do t’i godas ndonjë fitne në zemrat e tyre siç është kufri, nifaku, bidadi, ndonjë dënim i ashpër në dynja me vrasje, hakmarrje, burgosje apo ndonjë dënim tjetër të shpejt. All-llahu, subhanehu ve teala, e bëri bindjen ndaj Muhammedit, s.a.v.s, edhe ndjekjen e tij shkak për arritjen e dashurisë së Tij dhe falje të mëkateve. Ai thotë:

“Thuaj (Muhammed); ‘nëse e doni All-llahun, më pasoni mua, dhe All-llahu do t’iu dojë

juve dhe ju fal mëkatet tuaja". (Ali Imran: 31). Bindjen ndaj tij e beri udhëzim (hidajet) kurse kundërshtimin e tij e bëri devijim (dalalet). Ai thotë:

"Nëse ju (o besimtarë) i bindeni atij (Muhammedit) do te udhëzoheni" (En-Nur: 54), dhe thotë:

"E nëse ata nuk te përgjigjen ty, dije se ata pasojnë epshet e tyre, e kush është me i humbur se ai qe pason epshet e tij pa pasur kurrfarë udhëzimi nga All-llahu. All-llahu, vërtet, nuk e udhëzon popullin mizor" (El-Kasas: 50). All-llahu, subhanehu ve teala, gjithashtu, na lajmëroj se ai është shembulli me i mirë për ummetin e tij:

"Ju keni shembullin me te lart te Dërguarin e All-llahut, për atë që shpreson All-llahun (shpërblimin dhe takimin me Të) dhe Ditën e Gjykimit (se do te vij) dhe përmend atë shumë" (El-Ahsab: 21).

Ibnu Kethiri (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë: "Ky ajet fisnik është bazë e madhe rreth shëmbëllimit në të Dërguarin s.a.v.s, si në fjalët, veprat ashtu edhe ne gjendjen e tij. Për këtë arsye All-llahu, subhanehu ve teala, urdhëroj njerëzit (besimtarët) që ta marrin Muhammedin, s.a.v.s, p.sh mu ne ditën e Ahsabeve (ne luftën e Ahsabeve) si në durimin, qëndrueshmërinë, vëzhgimin, luftën dhe pritjen e tij te ardhjes se çlirimit nga Zoti i tij. Paqja dhe faljet e All-llahut, subhanehu ve teala, qofshin me të përgjithmonë."

All-llahu, subhanehu ve teala, bindjen ndaj Muhammedit, s.a.v.s, dhe pasimin e tij e përmendi në rreth dyzet vende ne Kur'an. Besimtarët kanë nevojë për njohjen e jetës se Muhammedit, s.a.v.s, dhe pasimin e rrugës se tij me shumë se për pije dhe ushqim, sepse, nëse ushqimi të mungon dhe nuk mund ta gjeshe, ndodhë vdekja ne dynja, ndërsa nëse te mungon bindja ndaj Muhammedit, s.a.v.s, dhe pasimi i rrugës se tij, ti ke arritur dënimin dhe mjerimin e përgjeshëm. Muhammedi, s.a.v.s, urdhëroj qe ta ndjekim atë ne kryerjen e ibadeteve dhe ato te kryhen ashtu sikurse i kryente edhe ai tha: "Faluni ashtu sikurse më keni parë duke u falur" e tha: "Merrni nga unë ritualet tuaja (për haxh)", dhe tha: "...ai qe punon një punë që nuk është ne pajtimin e çështjen (fenë) tonë, ajo punë i rikthehet atij", dhe tha "ai që largohet nga sunneti im (rruga ime) nuk është ai nga ne" dhe shumë tekste të tjera të ngjashme te cilat urdhërojnë qe ta pasojmë atë dhe mos ta kundërshtojmë.

Ligjshmëria e lutjes dhe selamit mbi të Dërguarin, s.a.v.s

E drejtë e Muhammedit, s.a.v.s, te cilën All-llahu, subhanehu ve teala, ia beri ligj ummetit te tij është salavati (lutja) dhe selami mbi të s.a.v.s. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Vërtet All-llahu dhe melaqet e Tij e madhërojnë pejagamberin (Muhammedin, alejhis-selam). O ju qe keni besuar! Madhëroni atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni atë me selam. (El-Ahsab: 56). Transmetohet se me fjalën "salatullah" (lutja e All-llahut) ka për qellim: lavdërimi i tij në mesin e melaqeve, dhe me "salatul-melaike" (lutja e melaqeve) do te thotë lutja e melaqeve dhe me "salatul-ademijine" (lutja e njerëzve) ka për qellim kërkimin e faljes nga ata. All-llahu, subhanehu ve teala, përmes këtij ajeti na lajmëroj për pozitën e robit dhe te profetit te Tij tek Ai në shoqërinë më të lartë, se ai e lavdëron atë tek melaqet më të afërta me

Të, po ashtu edhe melaqet luten për të, pastaj ai i urdhëroj banoret e botës më të ulët që të ulen për të dhe ta përshëndesin që kështu te bashkohet lavdërimi i tij nga banoret e botes se lart dhe te ulet.

Kuptimi i fjalës “sel-limu teslimen” (përshëndeteni me selam) është: që kur ta përshëndetni Muhammedin, s.a.v.s, bashkoni selamin dhe lutjen (salatil dhe salamin) e mos thuani vetëm “sal-lall-llahu alejhi” ose vetëm “alejhi selam” po thuani ashtu sikurse All-llahu, subhanehu ve teal: “sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem”.

Përshëndetja e Muhammedit, s.a.v.s, kërkohet ne disa vende, ndonjëherë mund të jetë obligim e ndonjëherë mustehab (gjë e dëshiruar).

Dijetari i madh Ibnul-Kajimi,(All-llahu subhanehu ve teal e mëshiroftë) përmendi dyzet e një vende ne librin e tij “Xhelaul-Efham” ku duhet përshëndetur Muhammedin, s.a.v.s, ai e filloj atë me fjalën:

Vendi i pare: pas ettihjatit (ne namaz) i cili është më i rëndësishmi dhe me i verifikuari. Të gjithë muslimanët (dijetarët) u pajtuan ne ligjshmërinë e tij. Por ata ranë në kundërshtim rreth asaj se a është obligim apo jo. Pastaj përmendi këto vende: ne duanë e kunutit, në salatul vitr, në hudbe (Ligjërata) siç është hudbja e namazit të xhumasë, të bajramit dhe istiskas (lutjen për shi) pas ezanit te muezinit, gjatë bërjes dua, gjatë hyrjes dhe daljes nga xhamia, gjatë përmendjes se Muhammedit, s.a.v.s, etj.

Pastaj ai, (All-llahu e mëshiroftë), përmendi dyzet dobi dhe fryte te lutjes dhe përshëndetjes së Muhammedit, s.a.v.s, nga ato:

- Kryerja e urdhrat te All-llahut, subhanehu ve teal e përmendur në ajetin e mësipërm.
- Arritja e dhjet lutjeve nga ana e All-llahut subhanehu ve teal, për atë që e përshëndet atë vetëm një herë.
- Shpresimi ne arritjen e përgjigjes nëse thua salavat para lutjes.
- Ai salavat është shkak për arritjen e shefatit (ndërmjetësimi te Muhammedit, s.a.v.s) nëse e bashkon me kërkimin e vesiles (vendin e lart për te).
- Salavati është shkak për faljen e mëkateve.
- Salavati është shkak qe Muhammedi, s.a.v.s, t’ia kthej atij përshëndetjen, etj.

Fe salavatullahi ve selamuhu ala hadhen-Nebijjil-Kerim.

Rreth vlerës se ehli bejtit dhe obligimeve ndaj tyre pa kurrfarë urrejtje apo teprimi

Ehlu-I-Bejti janë familja e Muhammedit, s.a.v.s, të cilëve u është ndaluar marrja e sadakës, (lemoshës). Nga ajo familje llogariten te jenë: familja e Aliut, e Xhaferit, e Akilit, e Abassit radiallahu anhu, bijt e El-Harith Ibnu-Abdul-Mutalibit, gratë dhe vajzat e Muhammedit, s.a.v.s. All-llahu, subhanehu ve teal,thotë:

“...All-llahu ka për qellim që nga ju, o familje e shtëpisë (së pejgamberit) te largojë ndytësinë e mëkateve dhe t’iu pastroj krejtësisht” (El-Ahsab: 33).

Imam Ibnu Kethiri (All-llahu e mëshiroftë).thotë: “ajo që nuk ka dyshim rreth këtij ajeti të Kur’anit, është se ky ajet përfshin edhe gratë e Muhammedit, s.a.v.s, sepse rrjedha e fjalëve është për to, për këtë arsye pas këtij ajeti All-llahu thotë:

“Përkujtoni (o ju gratë të peygamberit) ajo qe u lexohet nga ajetet dhe urtësia e All-llahut në shtëpitë tuaja” (El-Asab: 34), d.m.th. punoni sipas asaj qe All-llahu ia shpall Muhammedit, s.a.v.s, nga Kur’ani dhe suneti në shtëpitë tuaja. Komentuesi i njohur Katade dhe disa te tjerë kanë thënë: “Përkujtoni këtë begati me te cilën u veçuat ne mesin e njerëzve qe shpallja zbrit në shtëpitë tuaja. Aishja e singertë, e bija e te singertit (es-sid-dikatu bintus-sid-dik) u paraprinë dhe është me e veçantë me këtë begati dhe me këtë rahmet te madh, sepse Muhammedit, s.a.v.s, nuk i zbriti shpallja në shtratin e ndonjërës nga grat e tij përveç të saj, te cilën gjë e tregoi vet Muhammedi, s.a.v.s. Disa dijetar thonë: “...kjo është për arsye se ai nuk u martua me ndonjë vajzë beqare, me te cilën nuk fjeti ndonjë burrë tjetër, përveç saj. Kështu ajo u veçua me këtë cilësi dhe këtë shkallë te lart. Pra, nëse gratë e tij hyjnë brenda ehli bejtit, te afërmit e tij e meritojnë edhe me shumë”.

Ehklus-suneti vel-xhema a’ti (Pasuesit e Sunnetit dhe te xhematit te muslimanëve) e duan familjen (ehli bejtin) e Muhammedit, s.a.v.s, i ndihmojnë ata dhe ua ruajnë porosinë e Muhammedit, s.a.v.s, te cilën e tha në ditën e gadir humit (vend i ashtuquajtur mes Mekkes dhe Medinës): “ U a përkujtoj All-llahun në familjen time (ruane familjen time). Ehklus-suneti i duan ata dhe i respektojnë sepse një gjë e tillë është dashuri ndaj Muhammedit s.a.v.s. dhe respektimi i tij, si dhe është kusht që ata të jenë ndjekës të sunnetit të vërtetë në rrugën e drejtë të miletit islam, sikurse ishin të parët e ehli bejtit, sikurse janë Abbasi dhe Aliu me bijtë e tyre. Kurse ata të cilët e kundërshtojnë sunnetin dhe nuk i përmbahen fesë nuk bën t’i duash, edhe nëse janë nga ehli bejti,

Qëndrimi i ehklus-sunetit vel-xhema’atit ndaj Ehli Bejtit është qëndrim mesatar dhe i drejt, ata i duan fetarët dhe ndjekësit e rrugës së drejtë ne mesin e tyre, ndërsa spastrohen nga ata qe kundërshtojnë sunnetin dhe shmangen nga feja, edhe nëse ata janë nga Ehli Bejti, sepse qenia nga Ehli Bejti dhe afërsia e Muhammedit, s.a.v.s, nuk i bën ndonjë dobi, po te mos i përmbahet fesë së All-llahut. Transmeton Ebu Hurejretu r.a, se Muhammedit, s.a.v.s, kur i zbriti ajeti:

“Dhe tërhiq vërejtjen e familjes tende te afërt” (Esh-Shuara: 214), u ngrit e tha: “O ju grumbulli i kurejshit) apo një fjalë te ngjashme, bleni veten tuaj (ruani vetveten) se unë nuk mund t’iu ndihmoj asgjë para Zotit! O Abbas Ibnu Abdul-Mutal-lib nuk mund te ndihmoj asgjë para All-llahut. Oj Safije -halla e të Dërguarit të All-llahut- nuk mund të ndihmoj asgjë tek All-llahu. Oj Fatime, e bija e Muhammedit, kërko nga pasuria ime çka te dëshirosh, sepse unë nuk mund të bëjë dobi para All-llahut asgjë”.

Gjithashtu, Muhammedi, s.a.v.s, tha “Men betae ameluhu lem jusri’nesebuhu-punëpaktit nuk i benë dobi prejardhja e tij”. Ehklus Sunneti vel Xhemati janë të pastër nga rruga e rafidive (shiitëve) të cilët e teprojnë në disa persona nga ehli bejtit, duke u përshkruar atyre pa gabueshmërinë, si dhe nga rruga e atyre që kanë këmbëngulur armiqësinë kundër Ehli Bejtit të cilët janë te devotshëm, e të cilët i fyejnë (En-Nevasib). Gjithashtu, Ehklus-Suneti janë te pastër nga rruga e bidadxhive dhe bestyteve të cilët bëjnë ndërmjetësim me Ehli Bejtin dhe i konsiderojnë si Zota përveç All-llahut.

Ehklus-Suneti, në këtë çështje dhe ne çdo çështje tjetër, i përmbahen rrugës së mesme dhe të drejtë pa kurrfarë teprimi apo pakësimi. Edhe vet te devotshmit nga Ehli Bejti urrejnë

ekstremizmin në ta dhe spastrohen nga gultatet (ata qe kaluan kufirin në çështjen e tyre). Udhëheqësi i besimtarëve (Emirul Mu'minin), Aliu r.a. i dogji me zjarr gultatet te cilët u treguan ekstremist në çështjen e tij (duke i thënë zot apo profet), etj. Ibni Abbasi, r.a. e përkrahi atë me vrasjen e tyre me shpatë, e jo me zjarr si veproj Aliu r.a. Gjithashtu Aliu r.a. e kërkoj Abdulla Ibnu Sebein (munafikun çifut), kokën e gulateve që ta vras por ai iku dhe u fsheh (ky person çifut ishte ai i cili udhëhiqte nxitjen e trazirave dhe ky person llogaritet themeluesi i vërtetë i shiizmit ekstrem).

Rreth vlerës së sahabeve, besimi i obliguar për ta

Kush e gëzon ofiqin “Sahabe” dhe cili besim është i obliguar ndaj tyre

Es-Sahabe ne gjuhen arabe është shumësi i sahabi-ut. Sahabiu është personi i cili u takua me Muhamedin, s.a.v.s, i besoi atij dhe vdiq në atë besim. Është obligim të besohet se ata (sahabet) janë më të mirët në mesin e ummetit tonë dhe jetuan në shekujt më të mirë, si shkak i prirjes së tyre në islam, veçorisë së tyre në shoqërimin e Muhammedit, s.a.v.s, bashkëluftimit me të, marrjen e sheriatit nga ai, dhe komunikimin e tij për ata qe erdhën pas tyre. All-llahu i lartësuar i lavdëroi ata ne Librin e Tij, e thotë:

“All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (mekkasëve emigrues) dhe prej ensarëve (Medinasëve vendas e ndihmëtar te muhaxhirëve) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë te mira, edhe ata janë te kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhenete, ku rrjedhin lumenjtë dhe ku do te jenë përgjithmonë (pa vdekje). Vërtetë ky është fitim i madh” (Et-Tevbe: 100) dhe thotë

“Muhammedi është i Dërguari i All-llahut e ata që janë me të, janë te ashpër kundër pa besimtarëve e të mëshirshëm ndaj njeri tjetrit, i sheh ti ata si përuken (ne ruku), duke renë me fytyrë në tokë (duke bërë sexhde). Ata kërkojnë prej All-llahut që te ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre në këtë mënyrë është ne Tevrat. Kurse përshkrimi i tyre ne Inxhil është si një far e mbjellje së cilës i del filizi i vet, e ajo trashet-përforcohet dhe qëndron ne trungun e vet, ajo kështu e mahnit mbjellësin. All-llahu i shumoj ata, kështu për t’ua shtuar me ta mllëfin pabesimtarëve. All-llahu atyre që besuan dhe bënë vepra te mira, u premtoj falje të mëkateve dhe shpërblim të madh” (El-Fet’h: 29), dhe thotë:

“(Ajo pronë) U takon Muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive te tyre dhe prej pasurisë së tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë prej All-llahut dhe që ndihmojnë All-llahun e të Dërguarin e tij, të tillë janë ata te sinqertit. Edhe ata që përgatiten vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndienin ne gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili apo tjetër) nga ajo që u jepej atyre (Muhaxhirëve), madje sikur edhe të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetes. Ata që ruhen nga lakmia, ata janë të shpëtuar” (El-Hashr: 89).

Ne këto ajete All-llahu subhanehu ve teala lavdëroj Muhaxhirët dhe ensaret, te cilët i përshkroi se janë te paret ne veprimin e te mirave, se Ai është i kënaqur me ata, u përgatiti

atyre xhennetet, ata janë te ashpër kundër pabesimtarëve e të mëshirueshëm ndërmjet vete, bëjnë ruku dhe sexhde shumë, zemrat i kanë te pastra, në fytyrat e tyre shihet bindja ndaj All-llahut subhanehu ve teala, dhe imani, Ai i zgjodhi ata që ta shoqërojnë te Dërguarin e Tij, që kështu t'ua shtojnë mllëfin pabesimtarëve. Gjithashtu, i përshkroi muhaxhirët se i lanë vendet dhe pasurit e tyre për All-llahun subhanehu ve teala, forcimin e fesë se Tij dhe duke dëshiruar mirësinë e kënaqësinë e Tij dhe se ata janë te singertë në këtë. Ensaret i përshkruajtë se janë shtëpia e emigrimit, e ndihmës dhe e besimit te singertë. Gjithashtu, i përshkroi ata se i duan vëllezërit e tyre emigrues nga Mekka edhe me shumë se vetveten dhe me këtë arritën shpëtimin.

Këto ishin disa vlera te përgjithshme të sahabeve, ekzistojnë edhe cilësi e shkallë te veçanta, me të cilat ata u dalluan ndërmjet vete dhe kjo është sipas përparësisë së tyre në islam, në luftë për islamin dhe në emigrimin për fenë e All-llahut.

Sahabet me të mirë janë katër halifet e parë (El-Hulefahurr-Rrashidun): Ebu Bekri, Omeri, Osmani dhe Aliu, radiallahu anhum. Pas tyre vijnë te përgëzuarit me xhenet (për të cilët Muhammedi, s.a.v.s, tha se do të hynë në xhennet). Këta janë katër hafifet e përmendur me lartë dhe: Talha, Zubejri, Abdurrahman Ibnu Avfi, Ebu Ubejtedu, Ibnul-Xharrahi, Sa'd Ibnu Ebi Vekasi dhe Seid Ibnu Zejdi, radijallahu anhum. Pastaj, Muhaxhirët kanë përparësi ndaj Ensareve, pjesëmarrësit e luftës së Bedrit dhe të betimit te Rridvanit (Bej'Aturr-Rridvani-t)" dallohen mbi të tjerët, po ashtu ata që besuan para çlirimit te Mekës dhe luftuan qëndrojnë me lartë se ata që besuan dhe luftuan pas çlirimit te saj.

